

---

## BULETIN INFORMATIV

---

Tetor 2024

AKADEMIA E SHKENCAVE  
E SHQIPËRISË

---



---

**Buletin mujor i aktiviteteve të Akademisë së  
Shkencave të Shqipërisë**

Tetor, 2024

---

## Përmbajtje

<b>Aktivitete .....</b>	<b>6</b>
Një fjalor i madh për gjuhën shqipe .....	7
Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës zhvilluan konferencën e përbashkët “Krijimtaria e Shtjefën Gjeçovit” .....	8
Prof. Albert Hafner referon në Akademinë e Shkencave për rezultatet e projektit "Lin-3", që çuan në zbulimin e vendbanimit palafit liqenor më të vjetër në Europë - 8000-vjeçar.....	10
U zhvillua konferenca e dytë kombëtare e matematikës me temë “Analiza funksionale dhe teoria e funksioneve .....	13
Raport i OECD-së për konkurrueshmërinë në Ballkanin Perëndimor për vitin 2024 ....	15
Ritheksohet objektivi që buxheti për kërkimin shkencor në vendet e Ballkanit Perëndimor të arrijë në 2 për qind të produktit të përgjithshëm të tyre .....	17
Përfundon "Java e shkencës 2024", organizuar në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë .....	19
Akademia e Shkencave e Shqipërisë zhvillon workshopin “Sistemet online të informacionit kërkimor-shkencor, tendenca dhe risi” .....	21
Në 70-vjetorin e themelimit të "Organisation Européenne pour la Recherche Nucléaire" - CERN .....	22
Prezantohen punonjësit e rinj të instituteve dhe qendrave kërkimore të Akademisë së Shkencave .....	25
Qendra për koordinimin dhe përhapjen e informacionit shkencor dhe Biblioteka shkencore e Akademisë së Shkencave nisin kualifikimet e stafit bibliotekar .....	27
Në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë u zhvillua simpoziumi “Ekonomia qarkulluese në ndërtim” .....	28
Në datat 23 dhe 24 tetor u mbajt konferenca ndërkombëtare “Cobiss 2024” organizuar nga Instituti i Shkencave të Informacionit (IZUM) në Maribor (Slloveni), nën moton “Të punojmë së bashku për të ndërtuar besim dhe zhvillim në shkencë” .....	31
U zhvillua në Prishtinë konferenca shkencore ndërkombëtare “Shqiptarët dhe Lufta e Parë Botërore” .....	34

"Figura me vlera shkencore dhe kulturore shqiptare nga Lugina e Preshevës dhe vise të tjera" .....	36
Nis punimet konferenca shkencore ndërkombëtare "NanoBalkan 2024" .....	38
"Gratë në shkencë dhe teknologji" .....	42
Instituti i Gjuhësisë e Letërsisë dhe komisioni i përhershëm i këtyre dy fushave realizoi tryezën shkencore për çështjet e morfologjisë së sotme .....	44
Procesi i negociatave me Bashkimin Europian. Kapitulli 25 "Shkenca dhe kërkimi shkencor" .....	46
"Si ndërtohet një institucion i pavarur kulturor" .....	48
"Courage for Future" - "Kurajë për të ardhmen" .....	50
U zhvillua simpoziumi shkencor "Çarls Darvini dhe mendimi modern" .....	53
<b>Takime pune</b> .....	<b>55</b>
Vizitë pune e kryetarit të Akademisë së Shkencave të Lituanisë akad. Jūras Banyš në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë .....	56
Kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë akad. Skënder Gjinushi pret në një takim zyrtar ambasadorin e Rumanisë z. Octavian Şerban .....	60
Kryetari i Akademisë së Shkencave priti sot në një takim përfaqësues të Universitetit "Mohamed bin Zayed për Shkenca Humane" të Abu Dabit .....	63
<b>Mbledhje të komisioneve të përhershme të ASHSH</b> .....	<b>65</b>
Komisioni i përhershëm i ekonomisë, shkencave sociale dhe juridike zhvilloi mbledhjen e radhës për sfidat e turizmit shqiptar .....	66
<b>Vlerësime</b> .....	<b>68</b>
Autorja koreano-jugore Han Kang ka fituar çmimin Nobel në letërsi për vitin 2024 .....	69
Ermonela Jaho nderohet me çmimin "Artistja më e mirë e huaj" në Spanjë .....	71
Akademiku shqiptar Nazim Gruda zgjidhet zëvendëskryetar i Unionit të Akademive Europiane për Shkencën e Aplikuar në Bujqësi, Ushqim dhe Natyrë .....	72
Nderohen me çmimin "Nobel" në shkencat ekonomike studiuesit Daron Acemoglu, Simon Johnson dhe James A. Robinson .....	74
Shpallet çmimi Nobel 2024 në kimi për tre shkencëtarë .....	76
Ndahet Çmimi "Nobel" për fiziologji ose mjekësi .....	78

---

Geoffrey Hinton dhe John Hopfield fitojnë çmimin Nobel 2024 në fizikë për zbulime themelore që mundësojnë mësimin e makinerive me rrjete nervore artificiale .....	79
<b>Promovime.....</b>	<b>81</b>
Akademiku Anastas Angjeli promovoi në Bankën e Shqipërisë librin “Institucionet e Bretton Woods dhe Shqipëria” .....	82
<b>Të tjera .....</b>	<b>85</b>
155-vjetori i themelimit të Akademisë së Shkencave të Bullgarisë .....	86
Kryesia e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë i dërgon letër ngushëllimi Kryesisë së Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës për ndarjen nga jeta të akademikut Tahir Emra.....	88
Ambasada e Zvicrës në Shqipëri, përmes një postimi në faqen zyrtare të saj, falënderon Akademinë e Shkencave të Shqipërisë për mikpritjen e simpoziumit kushtuar zviceranit të famshëm Eugène Pittard, i cili bëri shumë për Shqipërinë .....	89
Studiuesi arbëresh Matteo Mandalà, anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave, përshëndet në emër të bashkësisë arbërore gjatë vizitës së Presidentit të Shqipërisë Begaj dhe të Presidentit të Italisë Mattarella në Sicili .....	91
<b>In memoriam.....</b>	<b>93</b>
Pesë vite pa akademikun, kolegun dhe mikun tonë Salvatore Bushati.....	94
Ndahet nga jeta akademik Tahir Emra, një ndër piktorët më të shquar të artit kosovar e shqiptar .....	97

---

# **Aktivitete**

## Një fjalor i madh për gjuhën shqipe

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi" dhe Akademia e Shkencave - konferencë shkencore mbi leksikografinë (Njoftimi në RTSH "Shkodra")



Në kuadër të Vitit të Gjuhës Shqipe, në bibliotekën universitare të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi" u zhvillua konferenca shkencore "Leksikografia shpjeguese shqipe e viteve 1930- 1940".

Veprimtaria u organizua nga Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, departamenti i gjuhësisë i këtij universiteti dhe Qendra e Studimeve Albanologjike pranë tij.

Akademiku Valter Memisha ndau lajmin e mirë mbi punën që po bëhet për hartimin e një fjalori të madh të gjuhës shqipe.

Java që po mbyllet ishte e ngjeshur për universitetin "Luigj Gurakuqi", me konferenca shkencore dhe takime promovuese dhe workshop-e me tematika të ndryshme.

Shih të plotë lajmin në linkun:

<https://www.rtsh-shkodra.live/nje-fjalor-i-madh-per.../>

Shih edhe:

<https://ata.gov.al/.../universiteti-i-shkodres-luigj.../>

<https://www.tiranadiplomat.com/.../universiteti-i.../>

<https://www.kultplus.com/.../universiteti-i-shkodres.../>

<https://frekuenca.net/.../43504-universiteti-i-shkodres.../>

---

**Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës zhvilluan konferencën e përbashkët “Krijimtaria e Shtjefën Gjeçovit”**



Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës zhvilluan konferencën e përbashkët “Krijimtaria e Shtjefën Gjeçovit”, me rastin e 150-vjetorit të lindjes së arkeologut të parë shqiptar, etnolog, shkrimtar, mbledhës e kodifikues i trashëgimit etnojuridik popullor shqiptar.



U zhvillua në Prishtinë konferenca shkencore ndërkombëtare me temën “Krijimtaria e Shtjefën Gjeçovit”. Në këtë konferencë mbajtën kumtesa akad. Sabri



Hamiti, akad. Shaban Sinani, akad. asoc. Gëzim Hoxha, prof. dr. Neritan Ceka, akad. Kujtim Shala, prof. asoc. dr. Edmond Malaj, prof. asoc. dr. Evalda Paci, dr. Marin Haxhimihali etj.



Akademikët dhe studiuesit folën për veprimtarinë e Shtjefën Gjeçovit, veprat e botuara dhe dorëshkrimet, për kontributin e tij në mbledhjen e thesarit popullor dhe të kulturës materiale e shpirtërore, si dhe për kontributin në formimin e muzeun françeskan, ku ekspozoi objekte të rëndësishme muzeore, armë, artefakte të rralla të veshjes, zbukurimores dhe të jetesës në familje.

Gjatë kësaj konference u vu në dukje kontributi i Shtjefën Gjeçovit në themelimin e arkeologjisë shqiptare dhe kodifikimin e veprës më të rëndësishme të trashëgimisë zakonore vendëse, Kanunin e Lekë Dukagjinit.

At Shtjefën Gjeçovi (Mëhill Konstandin Gjeçi - Kryeziu) ishte shkrimtar, publicist, përkthyes, klerik, etnograf dhe arkeolog. Ka lindur më 12 korrik të vitit 1874 dhe është vrarë me atentat më 14 tetor 1929.

**[www.akad.gov.al](http://www.akad.gov.al)**

---

**Prof. Albert Hafner referon në Akademinë e Shkencave për rezultatet e projektit "Lin-3", që çuan në zbulimin e vendbanimit palafit liqenor më të vjetër në Europë - 8000-vjeçar**



- Këto zbulime janë bërë në bazën e një projekti të përbashkët të Institutit të Arkeologjisë të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (ASHSH) dhe Universitetit e Bernës, Zvicër -

- Prof. Hafner është një nga personalitetet më në zë në Europë për studimin e vendbanimeve palafite -



Sot, në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, në sallën "Akademikët", prof. Albert Hafner mbajti leksionin e hapur mbi zbulimet arkeologjike në vendbanimin e

Linit.

Në këtë veprimtari ishin të pranishëm kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë akad. Skënder Gjinushi, zëvendëskryetari i ASHSH akad. Vasil S. Tole, kryetari i Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike akad. Gëzim Hoxha, drejtori i Institutit të Arkeologjisë akad. Adem Bunguri, anëtarë të ekipit dhe studiues dhe arkeologë të njohur.

Prof. Hafner argumentoi përmes këtij leksioni të hapur se gjetjet e reja në tokën shqiptare mund ta revolucionarizojnë njohjen arkeologjike për Europën parahistorike, si dhe për zanafillën e bujqësisë. Objektet e gjetura gjatë punës me projektin "Lin-3" çuan në zbulimin e vendbanimit palafit më të vjetër liqenor në Europë, që daton deri para 8000 vjetësh.



Duke marrë në konsideratë kërkimet arkeologjike nënujore të Institutit në liqenin e Ohrit, të cilat kanë nisur nga viti 2013, prof. Hafner, së bashku me kolegët shqiptarë filluan këtë projekt, në një vendbanim që mendohet të jetë ndër site-et arkeologjike më të mëdha të kësaj natyre.

Kërkimet dhe zbulimet në këtë sit arkeologjik dhanë rezultate shumë të mira për botën shkencore.

Në vitin 2023 analizat dendrokronologjike dhe ato me radiokarbon treguan që vendbanimet palafite në "Lin-3" ishin më të vjetrat në Europë, 6000 BC.

Këto studime lidhin paralele edhe me vendbanimet në Dunavec, Dispilo, Maliq dhe Plloçë.

Hafner e konsideron si vendbanimin më të vjetër liqenor të këtij lloji në Europë.

Gërmimet në sondazhet e tokës dhe ato nënujore në vitet 2021-2024 demonstrojnë që ky sit është banuar në vazhdimësi për rreth 2000 vjet, nga 6000 BC deri

---

në 4000 BC.

Prof. Hafner, në kuadër të këtij projekti të madh shqiptaro-zviceran, filloi një bashkëpunim të suksesshëm në Shqipëri me Institutin e Arkeologjisë.



Pas një eksperience të gjatë kërkimesh në vendbanimet palafite alpine, ai, në bashkëpunim me studiues të tjerë, nëpërmjet projektit europian "EXPLO", që nga viti 2018 ka fokusuar në studimet e tij vendbanimet palafite të Ballkanit Perëndimor.

Puna është në progres dhe rezultatet janë shumë premtuese.

[www.akad.gov.al](http://www.akad.gov.al)

---

## U zhvillua konferenca e dytë kombëtare e matematikës me temë “Analiza funksionale dhe teoria e funksioneve

- Dita e parë -

Seksioni i Shkencave Natyrore dhe Teknike i ASHSH dhe Instituti Kombëtar i Matematikës pranë saj çelën sot më 21 tetor 2024 ditën e parë të konferencës së dytë kombëtare të matematikës, me temë “Analiza funksionale dhe teoria e funksioneve”.

Veprimtaria u mbajt në sallën “Aleks Buda” në Akademinë e Shkencave dhe online, me pjesëmarrjen e profesorëve, doktorantëve në fushën e analizës, studentëve të matematikës nga universitetet shqiptare dhe institucionet shkencore brenda e jashtë vendit.

Kjo konferencë u drejtua nga prof. dr. Fioralba Cakoni (Rutgers University, New Jersey, SHBA), anëtare e jashtme e ASHSH e drejtuese ekzekutive e IKM dhe akad. Neki Frashëri, kryetar i SSHNT.

Akad. Skënder Gjinushi, Kryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, falënderoi organizatorët e konferencës dhe veçanërisht prof. dr. Fioralba Cakonin, si dhe gjithë ata që janë bashkuar në IKM.

Ai vuri në dukje se kjo veprimtari zhvillohet në kuadër të 100-vjetorit të lindjes së akademik Petraç Pilikës, themeluesit dhe drejtuesit historik të katedrës së matematikës në Shqipëri dhe bashkëthemeluesit të shkencës së informatikës. Akad. Gjinushi tha se shkolla që akad. Pilika themeloi është një trashëgimi shumë e vyer dhe kjo veprimtari është një përpjekje për të bërë bashkë matematikanët brenda dhe jashtë vendit. Më tej, ai theksoi rolin e ASHSH për të ruajtur këtë traditë të vyer dhe punën që po bëhet me IKM pranë kësaj akademie, pasi në një periudhë tranzicioni shumë të zgjatur shkolla është goditur në të gjitha nivelet e saj dhe konsiston me uljen e numrit dhe cilësisë së studentëve.

Akad. Gjinushi përmendi edhe dukurinë e emigrimit të trurit dhe falënderoi prof. dr. Cakonin dhe të gjithë ata shkencëtarë, që edhe pse punojnë jashtë vendit, po bashkëpunojnë me ASHSH.

Prof. dr. Eglantina Kalluçi, dekane e FSHN (UT), e cila falënderoi kryesinë e ASHSH për bashkëpunimin e vazhdueshëm me universitetet.

Sesionin e parë e moderoi prof. dr. Cakoni, e cila i dha fjalën Mishel Fundos për të vijuar drejtimin e punimeve të kësaj konference.

Referuan ditën e parë prof. dr. Mishel Fundo, prof. dr. Fioralba Cakoni, akad. Neki Frashëri, prof. dr. Fatmir Hoxha, prof. dr. Artur Baxhaku, prof. dr. Akli Fundo, prof. dr. Eglantina Kalluçi etj, të cilët paraqitën punime shkencore në fushat e kërkimit të matematikës teorike ose aplikative, si dhe punime shkencore në fushën e gjerë të


---

analizës, ku akademik Petraq Pilika dha kontributin e tij shkencor, por edhe në fushat e teorisë së funksioneve, teorisë së pikave fikse, teorisë së përafrimeve, si dhe probleme inverse.

**[www.akad.gov.al](http://www.akad.gov.al)**

---

## Raport i OECD-së për konkurrushmërinë në Ballkanin Perëndimor për vitin 2024



Raport i OECD-së për konkurrushmërinë në Ballkanin Perëndimor për vitin 2024 thekson për Shqipërinë rritjen ekonomike të vendit dhe sfidat që ai përballet në arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm.

Raporti përshkruan fushat kryesore, si qeverisja, infrastruktura dhe politikat sociale që kërkojnë vëmendje për të përmirësuar standardet e jetesës.

Ky raport gjithashtu thekson rëndësinë e transparencës dhe institucioneve efektive në krijimin e një ambienti që nxit investimet dhe stabilitetin ekonomik.

Përveç kësaj, ky raport shqyrton arsimimin dhe tregun e punës, duke theksuar se përmirësimi i aftësive dhe formimit profesional është thelbësor për të përputhur dhe

---

përshtatur fuqinë punëtore me nevojat e tregut. Ai thekson ndër të tjera se përmirësimi i rezultateve arsimore mund të çojë në një rritje të punësueshmërisë dhe produktivitetit, të cilat janë të rëndësishme për integrimin e Shqipërisë në ekonominë më të gjerë europiane.

Në këtë raport si përmbledhje trajtohet edhe qëndrueshmëria mjedisore dhe nevoja për Shqipërinë që të kalojë në politika e praktika më të gjelbra. Qëllimi përfundimtar i balancimit të zhvillimit ekonomik me mbrojtjen mjedisore duhet të sigurojë që rritja të mos vijë në dëm të burimeve natyrore, me vlerë për vendin. Duke adoptuar strategji gjithëpërfshirëse, Shqipëria mund të përmirësojë qëndrueshmërinë e saj dhe të hapë rrugën për një mirëqenie afatgjatë.

<https://westernbalkans-competitiveness.oecd.org/>

[www.akad.gov.al](http://www.akad.gov.al)



---

**Ritheksohet objektivi që buxheti për kërkimin shkencor në vendet e Ballkanit  
Perëndimor të arrijë në 2 për qind të produktit të përgjithshëm të tyre**  
(Sot dita përmbyllëse e samitit të tetë për shkencën në vendet e Ballkanit Perëndimor)

- Akad. Arben Merkoçi referon për punën në kuadër të European Research Area (ERA) dhe për përvojën e njesisë "NanoAlb" pranë Akademisë së Shkencave -  
- Prof. Odeta Barbullushi (Europe College, Tiranë) paraqiti problematika të rrjetit universitar kombëtar -

Dita përmbyllëse e samitit VIII për shkencën në vendet e Ballkanit Perëndimor në kuadër të Procesit të Berlinit



Seanca e parë e ditës përmbyllëse të këtij samiti iu kushtua diskutimeve mbi problemet e kërkimit që lidhen me pjesëmarrjen në Programin Kuadër - FP10.

Z. Shutte (Fondacioni "Volkswagen") theksoi hendekun midis kërkimit dhe tregut në Ballkanin Perëndimor, i parë në raport me konkurrencën në planin ekonomik, por dhe në atë të grumbullimit të dijeve, me nevojën për financimin e ekselencës, mekanizmat për forcimin e lidhjeve kërkim-industri, duke krijuar mjedis pozitiv për kërkimin dhe financimin.

Seanca e dytë u drejtua nga akad. Arben Merkoçi. Ai përshkroi përvojën nga veprimtaritë e grupit ERA të ALLEA-s, nevojën për financimin e ekselencës në shkencë dhe ndau me të pranishmit përvojën e njesisë kërkimore "NanoAlb".



Në vijim nga pjesëmarrësit u diskutuan çështje që lidhen me:

- Vizionin, sfidat dhe kërkesat specifike që ka Programi Kuadër - FP10;
- Domosdoshmërinë e ushtrimit të presionit ndaj qeverive të vendeve të Ballkanit Perëndimor për rritjen me 2% të financimit për shkencën;
- Arritjen e unitetit solidaritet plus konkurrencë si mbështetje më e plotë në nivel kombëtar dhe rajonal në fushën e shkencës, për të pasur sukses në programin e ardhshëm FP10;
- Vijimin e bashkëpunimit midis vendeve të Ballkanit Perëndimor në fushën e shkencës, për të qenë në koherencë me BE-në.

Seanca e tretë, e moderuar nga znj. Barbullushi, iu dedikua debatit për rolin e Procesit të Berlinit në fushën e shkencës dhe afrimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor me standardet europiane nëpërmjet masave të ndryshme dhe forcimit të burimeve njerëzore.

Seanca e fundit e mbledhjes u mbajt në mjediset e Parlamentit të Gjermanisë.

Z. Kai Gehring, kryetar i komitetit për edukimin, kërkimin dhe teknologjinë, ishte i pranishëm në këtë takim së bashku me anëtarët e grupit të Procesit të Berlinit, ku paraqitën një përmbledhje të çështjeve të trajtuara gjatë dy ditëve të konferencës dhe punën e bërë për nxitjen e edukimit dhe kërkimit shkencor.

[www.akad.gov.al](http://www.akad.gov.al)

---

## Përfundon "Java e shkencës 2024", organizuar në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë

- Veprimtarinë e mbylli prof. Salvatore Buontempo, me referatin "Fizika e grimcave elementare në CERN: zbulime dhe teknologji të reja" -



Dita e fundit e kësaj veprimtarie u drejtua nga dr. Ilirjan Margjeka (INFN dhe "CMS experiment at CERN").

Prof. Salvatore Buontempo (grupi CMS - RPC, CERN / HEP, CERN, LHC, CMS technologies / e mbylli veprimtarinë me prezantimin "Fizika e grimcave elementare në CERN: zbulime dhe teknologji të reja".

Përgjatë zhvillimit të veprimtarisë u bënë prezantime me një spektër të gjerë, duke filluar nga fizika e energjive të larta dhe ajo e grimcave elementare, deri tek studimet e trashëgimisë kulturore të Shqipërisë, të fizikës mjekësore e astrofizikës, si dhe studimet didaktike.

"Java e shkencës" u organizua nga departamenti i fizikës (FSHN) dhe Instituti kombëtar i Fizikës pranë Akademisë së Shkencave, i drejtuar nga akad. asoc. Mimoza Hafizi; me mbështetjen e Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (Albanian-American Development Foundation, AADF), përmes programit "Research Expertise

---

from the Academic Diaspora" (READ).



[www.akad.gov.al](http://www.akad.gov.al)

---

## Akademia e Shkencave e Shqipërisë zhvillon workshopin “Sistemet online të informacionit kërkimor-shkencor, tendenca dhe risi”



Veprimtaria u organizua nga Akademia e të Rinjve dhe Qendra për Koordinimin dhe Përhapjen e Informacionit Shkencor.

Ky aktivitet ka për qëllim informimin e kërkuesve të rinj (që punojnë në IAL, institute kërkimore apo si kërkues të pavarur) për njohjen me sistemet online të informacionit kërkimor, konkretisht rrjetet COBISS dhe E-CRIS.


Përmes informimit synohet rritja e përhapjes së lexueshmërisë, numri i citimeve të punës shkencore të kërkuesve të rinj, etj.

Shih linkun:

<https://www.facebook.com/share/p/xCB82cipQmxDWsPm/?mibextid=WC7FNe>  
[www.akad.gov.al](http://www.akad.gov.al)

---

## Në 70-vjetorin e themelimit të "Organisation Européenne pour la Recherche Nucléaire" - CERN



- Sot dita e parë e "Javës së shkencës në Tiranë", edicioni i dytë, organizuar në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë -

- Veprimtaria zhvillohet në kuadër të festimeve të 70-vjetorit të CERN-it dhe fokusohet në bashkëpunimin mes universiteteve të Shqipërisë dhe eksperimentit "Compact Muon Collider" (CMS)



U zhvillua dita e parë e edicionit të dytë të “Javës së shkencës në Tiranë”, veprimtari e Institutit Kombëtar të Fizikës pranë Akademisë së Shkencave, në bashkëpunim me departamentin e fizikës (Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës).

Veprimtarinë e përshëndeti akad. Mimoza Hafizi, drejtuese e Institutit Kombëtar të Fizikës.



Në vijim, prof. dr. Gerti Xhixha, drejtues i departamentit të fizikës, foli për risitë e punës kërkimore të studentëve të doktoratës në FSHN të UT dhe akad. Hafizi prezantoi eksperimentet që provojnë ndërthurjen kuantike.

Studiuesi italian Silvano Tosi (INFN Genova dhe CMS, CERN) paraqiti rezultatet

---

e fizikës së kuarkeve top në eksperimentet e CMS-CERN, ndërsa prof. dr. Ilirjan Margjeka (INFN dhe CMS) - punimin shkencor "Nga modeli teorik deri tek vëzhgimi i eksperimentit".

Veprimtaria u mbyll me referimet e studentëve të doktoratës në Fakultetin e Inxhinierisë Matematike dhe Fizike të Universitetit Politeknik të Tiranës.

“Java e shkencës 2024” zhvillohet ne kuadër të përvjetorit jubilar të 70-vjetorit të CERN-it.

Rrugëtimi drejt CERN-it ka nisur në vitin 2011, kur, falë përpjekjeve të vazhdueshme të të ndjerit akad. Artan Boriçi dhe të akad. Mimoza Hafizi janë organizuar në Shqipëri disa aktivitete në lidhje me këtë qendër kërkimore.

**[www.akad.gov.al](http://www.akad.gov.al)**



## Prezantohen punonjësit e rinj të instituteve dhe qendrave kërkimore të Akademisë së Shkencave



Kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akad. Skënder Gjinushi ka zhvilluar një takim për t'u prezantuar me punonjësit e sapoemëruar të instituteve dhe qendrave pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Në këtë takim akad. Gjinushi vlerësoi kurrikulumet e konkurrentëve, si dhe punën e mirë të komisioneve në përzgjedhjen e tyre, bazuar vetëm mbi kriteret profesionale. Ai vuri në dukje punën dhe rolin e institucioneve kërkimore, vlerën dhe rëndësinë e projekteve të mëdha shkencore të ndërmarra nga ASHSH, në fushën e albanologjisë, e më gjerë.

Më tej, Kryetari i ASHSH, akad. Gjinushi, diskutoi për përfshirjen sa më plotë të punonjësve të rinj në jetën institucionale.

Tashmë, institutet dhe qendrat pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë janë plotësuar me 8 punonjës të rinj shkencor.

Punonjësit e sapoemëruar janë:

1. Dr. Stefano Romano, punonjës kërkimor shkencor, në specialitetin studiuës i arteve: arkitekturës/planifikimit urban/artit në hapësirën publike" në Qendrën e Studimit të Arteve, pranë Akademisë së Shkencave.

2. Dr.Kreshnik Duqi, punonjës kërkimor shkencor, në specialitetin studiuës i arteve: muzikë, në Qendrën e Studimit të Arteve pranë Akademisë së Shkencave.

3. Dr. Aristotel Spiro, Punonjës kërkimor shkencor, me fushë kërkimi: Studime në gramatikë historike, në Institutin e Gjuhësisë dhe Letërsisë pranë Akademisë së Shkencave.



4. Dr. Neli Naço, Punonjës kërkimor shkencor, (i cili do të mbulojë fushat e folklorit të shkruar), në Institutin e Antropologjisë pranë Akademisë së Shkencave.

5. Dr. Silvana Nini, punonjës kërkimor shkencor, (e cila do të mbulojë fushat e arteve dhe dijeberjes tradicionale), në Institutin e Antropologjisë pranë Akademisë së Shkencave.

6. Erikson Nikolli, punonjës kërkimor shkencor, në Institutin e Arkeologjisë pranë Akademisë së Shkencave.

7. Suela Xhyheri, punonjës kërkimor shkencor, në Institutin e Arkeologjisë pranë Akademisë së Shkencave.

8. Surja Lela, asistent kërkues-shkencor, në Institutin e Arkeologjisë pranë Akademisë së Shkencave.

---

## Qendra për koordinimin dhe përhapjen e informacionit shkencor dhe Biblioteka shkencore e Akademisë së Shkencave nisin kualifikimet e stafit bibliotekar



Qendra për koordinimin dhe përhapjen e informacionit shkencor në bashkëpunim me Bibliotekën shkencore të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, nisin kualifikimet e stafit të ri bibliotekar për të punuar në programin Cobiss.

Pas reformimit të Akademisë së Shkencave dhe ribashkimit të saj me institutet shkencore të albanologjisë, fondi i Bibliotekës shkencore të ASHSH-së është zgjeruar edhe me koleksionet e bibliotekës albanologjike të instituteve.

Në këto kushte, është i domosdoshëm digjitalizimi i kësaj pjese të rëndësishme që tashmë funksionon si pjesë qendrore e fondit të bibliotekës së Akademisë së Shkencave, një fond i vyer në ndihmë të kërkuesve shkencorë.

Digjitalizimi, si një proces i rëndësishëm i bibliotekës, lidhet jo vetëm me regjistrimin e njësive bibliografike të fondit të saj, por dhe me vazhdimin e krijimit të bibliografive shkencore online dhe, së shpejti, do të pasurohet me procese inovative që lidhen me regjistrimin e artikujve shkencorë me tekst të plotë, që do të synojnë të bëjnë të mundur vlerësimin e arritjeve shkencore në platforma ndërkombëtare të publikimeve shkencore.

## Në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë u zhvillua simpoziumi “Ekonomia qarkulluese në ndërtim”



Veprimtaria u organizua nga Seksioni i Shkencave Natyrore e Teknike (SSHNT) i Akademisë së Shkencave, në bashkëpunim me Institutin e Ndërtimit, Fakultetin e Shkencave të Natyrës të UT dhe Agjencinë Kombëtare të Mjedisit.

Ishin të pranishëm Kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë akad. Skënder Gjinushi, zëvendëskryetari i ASHSH akad. Vasil S. Tole, drejtues nga Ministria e Mjedisit, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, Shoqata e Ndërtuesve, Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, si dhe prodhues të materialeve të ndërtimit, specialistë të laboratorëve për testimin e produkteve të ndërtimit, ekspertë të certifikimit të produkteve të ndërtimit, përfaqësues të shoqatave mjedisore etj.

Akad. Neki Frashëri, kryetar i SSHNT, përshëndeti të pranishmit dhe vuri në dukje se çështja e riciklimit të inerteve sot ka marrë përmasa të zgjeruara dhe zhvillimi i një veprimtarie të tillë do të ketë ndikim në vendin tonë.

Drejtori i Institutit të Ndërtimit z. Artan Shkreli tha se me këtë takim do të hapet rruga për njohjen e problemeve. Ekonomia qarkulluese në ndërtim është një qasje e re që synon të reduktojë ndikimin negativ mjedisor të industrisë së ndërtimit, si një nga industritë më të mëdha, përmes shfrytëzimit të qëndrueshëm të burimeve, duke maksimizuar përdorimin e materialeve të ricikluara dhe të ripërdorshme. Më tej ai

shprehu mirënjohjen që Akademia e Shkencave po koordinon me veprimtari praktike në shkencë dhe në ekonomi.



Në kumtesat e tyre znj. Arta Dollani, ing. Alfred Lako, dr. Enkelejda Shkurta, ing. Mentor Fraholli, prof. Kledi Xhaxhiu, akad. asoc. Besnik Baraj, prof. Arjan Korpa, ing. Gëzim Dapi dhe ing. Rezarta Shullazi prezantuan gjendjen aktuale në Shqipëri, kryesisht të administrimit të mbeturinave nga industria e ndërtimit dhe mbeturinat e tjera industriale.



Më tej u diskutua legjislacioni aktual dhe nevoja për ndryshime, duke iu përfruar legjislacionit europian dhe ndërgjegjësimi mbi nevojën e riciklimit të

---

materialeve të ndërtimit.

Përgjatë këtyre prezantimeve u arrit në përfundimin se ka lindur nevoja e një modeli të ekonomisë qarkulluese që të shfrytëzojë sa më shumë materialet dhe burimet në dispozicion të shoqërisë.

**[www.akad.gov.al](http://www.akad.gov.al)**

Në datat 23 dhe 24 tetor u mbajt konferenca ndërkombëtare "Cobiss 2024" organizuar nga Instituti i Shkencave të Informacionit (IZUM) në Maribor (Slloveni), nën moton "Të punojmë së bashku për të ndërtuar besim dhe zhvillim në shkencë"



Në këtë konferencë morën pjesë përfaqësues të Akademisë së Shkencave: znj. Mirlona Buzo, drejtuese e qendrës për koordinimin dhe përhapjen e informacionit shkencor (QKPISH); znj. Elda Zotaj, drejtuese e zyrës së marrëdhënieve me jashtë dhe publikun dhe znj. Albana Velianj drejtuese e bibliotekës shkencore, si dhe drejtues të bibliotekave universitare dhe publike në vend.

Ishin të pranishëm më shumë se 200 pjesëmarrës.

Në konferencë referuan ekspertë të njohur nga vendet anëtare në platformën "[Cobiss.net](https://cobiss.net)" dhe nga qendra e institucione ndërkombëtare në fushën e teknologjisë së informacionit, përfaqësues të bibliotekave të rajonit dhe më gjerë, si dhe përfaqësues të institucioneve kërkimore të Sllovenisë.

Kjo ishte konferenca e 24-të "Cobiss", ku referuesit adresuan çështje aktuale dhe prezantuan tema bashkëkohore lidhur me mundësinë e përdorimit të inteligjencës artificiale në platformat digjitale që zbatojnë bibliotekat në shërbimet e tyre ndaj përdoruesve, diskutime mbi aksesin e shërbimeve për grupet me aftësi të

kufizuar, prezantimin dhe promovimin e shërbimeve të reja "Cobiss Ela", "Cobiss Lib", "Cobiss Cat" dhe "Cobiss+".

Në prezantimin e këtij viti në Konferencën COBIS 2024, drejtuesja e qendrës QKPISH **Mirlona Buzo** u paraqit me punimin e saj "Krijimi i qendrës për koordinimin dhe përhapjen e informacionit shkencor (QKPISH) - sfida dhe perspektiva". Bashkëpunimi midis Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe IZUM-it ka hyrë në një fazë të re me ngritjen e kësaj qendre.



Të pranishmit u njohën me risitë dhe funksionet e kësaj qendre për institucionalizimin e sistemeve të informacionit "Cobiss.al" dhe "Ecris.al", si dhe për konsolidimin e rrjetit të përbashkët të të dhënave për kërkimin shkencor dhe zgjerimin e rrjetit të bibliotekave në Shqipëri.

Drejtuesja theksoi se qendra synon të sinkronizojë në nivel kombëtar përfshirjen dhe planifikimin e aktiviteteve që lidhen me qendrat e informacionit (institute shkencore, agjenci kërkimore e zhvillimore, biblioteka të IAL-ve, institucione shkencore dhe bibliotekat publike).

QKPISH synon përpunimin e një strategjie për të përhapur kërkimin shkencor në mënyrë sa më eficientë, duke iu krijuar mundësinë kërkuesve shkencore të kenë metodat më moderne për aksesin e informacionit dhe të stimulojë bashkëpunimin midis kërkuesve shkencore shqiptare.

Qendra do të inkurajojë integrimin e përmbajtjes digjitale në faqet e internetit dhe pajisjet celulare në përshtatje me aplikacione dhe mjete të reja.



---

Konferenca u ofroi një mundësi pjesëmarrësve të shkëmbejnë praktika, të ekspozojnë arritjet dhe adresimin e sfidave të përbashkëta për të ardhmen.

[www.akad.gov.al](http://www.akad.gov.al)

Shih dhe linkun në vijim:

<https://ata.gov.al/.../konference-shkencore-mbi.../>

<https://www.kultplus.com/.../konference-shkencore-mbi.../>

<https://frekuenca.net/.../44020-konference-shkencore-mbi...>

<https://www.facebook.com/100066373886656/posts/878307434391711/?app=fbl>

<https://x.com/COBISSNET/status/1848288167784296767>

## U zhvillua në Prishtinë konferenca shkencore ndërkombëtare “Shqiptarët dhe Lufta e Parë Botërore”



Në datën 25 tetor 2024, u mbajt konferenca shkencore ndërkombëtare “Shqiptarët dhe Lufta e Parë Botërore” e organizuar nga Instituti i Historisë “Ali Hadri” në Prishtinë në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë dhe Institutin e Historisë, Tiranë, si dhe me Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”.

Akad. Beqir Meta mbajti kumtesën me temën "Shqiptarët e ndarë në Luftën e Parë Botërore-ritakim në dhimbje".

Prof. asoc dr. Ledia Dushku paraqiti kumtesën për propagandën në luftë, duke i bërë një portretizim Shqipërisë, mbështetur në studimin e dr. Max Müller (Mynih, 1916)".

Akad. Marenglen Verli paraqiti kumtesën “Shqipëria, Kosova dhe çështja shqiptare në Konferencën e Paqes në Paris 1919-1920”.

Është paraqitur edhe referati I Romeo Gurakuqit, "Shqipëria në “Luftën e Madhe”, nga anarkia politike dhe pushtimet e fqinjëve, tek autonomia e

---

kontrolluar nga shteti protektor Austro-Hungarinë, pavarësia e mbikqyrur e Italisë dhe Republika e Korçës".

Prof. asoc. dr. Sali Kadria foli për arsimin kombëtar në territoret shqiptare që ndodheshin nën okupimin austro-hungarez (1916-1918)".

Dr. Edon Qesari, mbajti një kumtesë për gjendjen social-kulturore të hapësirave rurale në Shqipëri përgjatë Luftës së Parë Botërore".

Kjo konferencë u krijoi mundësi studiuesve që të paraqesin arritjet e tyre shkencore, si dhe të shkëmbejnë mendime mbi ngjarjet historike të kësaj periudhe.

## "Figura me vlera shkencore dhe kulturore shqiptare nga Lugina e Preshevës dhe vise të tjera"

- Konferencë dyditore e organizuar nga Shoqata për Trashëgimi dhe Krijimtari Kulturore Shqiptare në Luginën e Preshevës -



Akademia e Shkencave pjesëmarrëse me kontributet shkencore të punonjësve të saj: akad. Adem Bunguri (gjithashtu anëtar i bordit shkencor-organizues), prof. d. Neritan Ceka (kryetar i komisionit të përhershëm të arkeologjisë pranë ASHSH), akad. Valter Memisha (drejtor i Institutit të Gjuhësisë e Letërsisë) dhe prof. dr. Hamit Kaba (drejtor i Institutit të Historisë).

Konferenca u zhvillua më datat 26-27 tetor, në "Bici-Resort" (Preshevë).

Morën pjesë me referime si autorë e bashkautorë 52 studiues nga të gjitha trevat shqiptare dhe u lexuan 40 kumtesa.

I pranishëm Ambasadori i Shqipërisë në Beograd dr. Bardhyl Canaj dhe konsulli Ildir Kaba.

Z. Xhemaledin Salihi, kryetar i shoqatës, shprehu falënderime të posaçme për mbështetjen për akad. Skënder Gjinushin, kryetar i ASHSH dhe për pjesëmarrësit nga radhët e akademikëve e bashkëpunëtorëve të saj.

Akademia e Shkencave do të dhurojë koleksionin e botimeve të saj për

---

bibliotekën e shoqatës.

Kjo konferencë zhvillohet për herë të dytë me bashkëpunimin e Akademisë.  
Gjatë konferencës u përruan aktet e konferencës së parë.



## Nis punimet konferenca shkencore ndërkombëtare "NanoBalkan 2024"

- Konferenca zhvillon punimet nga 28 tetori deri më 1 nëntor 2024 -
- Përshëndetën konferencën kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë akad. Skënder Gjinushi; ministrja e Arsimit dhe Sporteve znj. Ogerta Manastirliu; zëvendëministri i Bujqësisë z. Arian Jaupllari; ambasador i Spanjës në Shqipëri z. Alvaro Renedo; zëvendësministri i Shëndetësisë z. Niko Hyka -



Këtë të hënë, më 28 tetor 2024, në Pallatin e Kongreseve në Tiranë u çel konferenca ndërkombëtare "NanoBallkan 2024".

Fjalën e hapjes e mbajti akad. Arben Merkoçi, anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, drejtues i qendrës "NanoAlb", profesor i ICREA-s në Institutin Katalan të Nanoshkencës dhe Nanoteknologjisë në Barcelonë (Spanjë).

Ai theksoi se konferenca ndërkombëtare "NanoBalkan" (NB2024) po zhvillohet pas suksesit të dëshmuar në tre eventet e fundit të organizuara në Shqipëri: "TNT2021", "TNT nanoBalkan2022" dhe "nanoBalkan2023". Ky edicion do të ofrojë një mundësi unike për ndërveprim të gjerë me sesione ose seminare specifike me tema të mprehta. Seminaret bashkëpunuese do të jenë: Shqipëri-Japoni-Spanjë për nanoteknologjinë dhe

Shqipëri-Itali-Spanjë mbi nanomjekësinë, si dhe shkolla për nanobiosensorët, workshope etj.

Akad. Merkoçi falënderoi edhe kolegët e qendrës "NanoAlb" të Akademisë së Shkencave si bashkorganizatorë të konferencës: prof. dr. Majlinda Vasjarin, akad. Besnik Barajn dhe prof. dr. Kledi Xhaxhiun.

Në vijim akad. Merkoçi ia dha fjalën akad. Skënder Gjinushit, kryetar i Akademisë së Shkencave.



Akad. Gjinushi u uroi mirëseardhjen pjesëmarrësve në emër të Akademisë së Shkencave dhe e vlerësoi konferencën si eventin më të rëndësishëm shkencor që organizohet në Shqipëri për nga numri e niveli shkencor i pjesëmarrësve, të ardhur nga qendrat ndër më elitare të kërkimit shkencor në Europë e më gjerë, nga mbi 20 vende të ndryshme, universitete e institute me emër, të linjës së parë në fushën e nanoteknologjisë.

Akad. Gjinushi vuri në dukje se kjo konferencë zhvillohet në një moment të veçantë, kur Shqipëria sapo ka hapur negociatat me BE për anëtarësimin e saj në familjen europiane, ku një ndër sfidat më të mëdha është arritja e standardeve europiane edhe në fushën e kërkimit.

Ai theksoi se vetë Europa ka rritur objektivat e saj për të investuar në kërkim rreth 3 për qind të GDP-së së çdo vendi, çka e bën më të vështirë e më ambicioz objektivin e vendeve si vendi ynë që këtë tregues e ka nën 0,5 për qind.

---

Është ky bashkëpunim që ka bërë që një raport i Bankës Botërore për zhvillimin e kërkimit shkencor në rajon ta vlerësojë përvojën e njësisë "NanoAlb" si një model suksesi me efekte të veçanta për ndaljen e ikjes së trurit, si dhe për mënyrën sesi mund të shfrytëzohet e përfitohet nga përvoja e kualifikimi i të larguarve, dhe për këtë, miku e kolegu ynë Merkoçi meriton një falënderim të posaçëm, ashtu si dhe ne që po dimë "ta shfrytëzojmë" atë.



Më tej akad. Gjinushi foli për zhvillimet që do të çojnë drejt adaptimit të një ligji për shkencën të standardeve të kohës.

Më pas, ministrja e Arsimit dhe Sporteve, znj. Ogerta Manastirliu e vlerësoi këtë veprimtari si një ngjarje të rëndësishme dhe siguroi mbështetjen e vazhdueshme të qeverisë shqiptare për kërkimin shkencor dhe zhvillimin e infrastrukturës kërkimore në vend, si dhe miratimin së shpejti të ligjit të ri për shkencën dhe kërkimin shkencor.

Zëvendësministri i Bujqësisë z. Arian Jaupllari e vlerësoi konferencën si veprimtari që zgjon perspektiva të reja në bujqësinë shqiptare, që lidhen me përfshirjen e teknologjisë dhe inteligjencës artificiale në funksion të një bujqësie të orientuar drejt standardeve të BE-së.

Punimet e kësaj konference i përshëndeti ambasadori i Spanjës në Shqipëri z. Alvaro Renedo, i cili premtoi mbështetjen e vazhdueshme të qeverisë spanjolle në të



gjitha veprimtaritë shkencore që lidhen me shkencën dhe nanoteknologjinë dhe shprehu mirënjohjen për organizatorët; bashkëdrejtuesin e kësaj konference akad. Arben Merkoçin, fondacionin "Phantoms" në Spanjë, Institutin Katalan të Nanoshkencës, si dhe qendrën kërkimore "NanoAlb" me mbështetjen e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Zëvendësministri i Shëndetësisë z. Niko Hyka, që ka qenë pjesë e grupit të kërkuesve shkencorë në nanoteknologji e vlerësoi konferencën si një ndërmarrje sfiduese të veçantë. Ai tha se detyra është të bashkëpunojmë me kërkuesit shkencorë sesi të integrojmë të rehat shkencore në mjekësi. Fushat e aplikimit janë të shumta, siç janë mjekësia rigjeneruese, nanorobotët etj.



Në ditën e parë të konferencës u prezantuan tema interesante në nanoshkencë dhe nanoteknologji nga Andrea Ferrari (Cambridge Graphene Centre / Universiteti i Kembrixhit, Mbretëria e Bashkuar; Michal Otyepka (RCPTM, Republika Çeke); Ece Eksin (Universiteti Demokracia, Izmir, Turqi).

Në ditën në vijim gama e veprimtarive do të përfshijë nanomjekësinë, shkollën për nanobiosensorët, ëorkshop-in mbi mjedisin, workshop-in "Gratë në nanoteknologji", një seminar për sipërmarrësit etj.

## "Gratë në shkencë dhe teknologji" Workshop në kuadër të konferencës "NanoBallkan 2024"



Workshop-i u zhvillua nga AlbanianWomeninNanotechnology (AWIN) në bashkëpunim me NanoAlb në Pallatin e Kongreseve, si pjesë e konferencës ndërkombëtare NanoBalkan2024.

Ky workshop ka mbledhur së bashku 30 pjesëmarrëse gra nga Shqipëria dhe vende të tjera të botës.

Synimi i workshop-it është për t'u njohur me arritjet shkencore të grave në disa fusha si: mjekësia dhe shëndetësia; telekomunikacioni dhe transporti; prodhimi dhe gjysmëpërçuesit; bioteknologjia dhe farmaceutika; energjia dhe ushqimi, klima dhe mjedisi.

Kjo veprimtari ofroi platformën për diskutimin e mënyrave sesi teknologjia e avancuar ka transformuar proceset e kërkimit dhe praktikat e biznesit.

Mbështetja dhe vlerësimi për gratë e suksesshme në shkencë vjen gjithmonë nga kolegët burra, të cilët luajnë një rol të rëndësishëm si mbështetës, vlerësues dhe motivues.

Për më tepër vizitoni:

<https://www.nanobalkanconf.com/2024/WorkshopWomen.php>



## Instituti i Gjuhësisë e Letërsisë dhe komisioni i përhershëm i këtyre dy fushave realizoi tryezën shkencore për çështjet e morfologjisë së sotme



Sot, më 29 tetor 2024, instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, në bashkëpunim me komisionin e përhershëm të këtyre dy fushave zhvilloi një tryezë shkencore me temën “Çështje të morfologjisë së sotme”.

Veprimtaria u mbajt në sallën “Akademikët”, me pjesëmarrjen (fizikisht dhe online) e studiuësve nga IGJL-ja; të anëtarëve të komisionit dhe të profesorëve nga Universiteti i Tiranës; Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës dhe Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan.

Dr. Leonard Dauti prezantoi studimin për konstruktet modale të shqipes dhe vlerën diskursive të tyre (vështruar në kontekstin e respektimit të normës standarde). Ai trajtoi modalitetin në gjuhën shqipe në raport me normën standarde dhe përkufizoi atë si shprehjen e qëndrimit të folësit ndaj përmbajtjes së fjalëve të tij në lidhje me realitetin objektiv, duke përfshirë vlerësimin subjektiv, mundësinë, lejimin dhe domosdoshmërinë e një veprimi.

Gjithashtu dr. Dauti prezantoi qasjet kryesore teorike të modalitetit nga autorë si Halliday, Lyons dhe Palmer etj. dhe përfshirjen e kuptimeve subjektive dhe direktive që mungojnë në disa gjuhë të tjera.

Në përfundim të referimit ai propozoi një përkufizim gjithëpërfshirës të modalitetit për gjuhën shqipe, duke nënvizuar nevojën për një koncept fleksibël që përfshin një gamë më të gjerë të nuancave të folësit.



Më pas tryeza vijoi me referimin e dr. Resul Telhajt, me temë “Tipat kumtuesorë të fjalive dhe mënyrat e foljes”, ku përshkruhen tipat kumtuesorë të fjalive: dëftore, pyetëse, urdhërore, thirrmore e dëshirore në kuadër të teorisë së akteve të ligjërimin dhe të semantikës dinamike, për realizimin e një analize gjithëpërfshirëse të konceptit të mënyrës, veçanërisht semantikën dhe pragmatikën.



Në përfundim, prezantimi synoi të zgjerojë njohuritë mbi ndërtimin e fjalive dhe kuptimet e tyre gramatikore, duke shqyrtuar faktet gjuhësore të shqipes në këto drejtime.

Pas referimeve, nga të pranishmit pati diskutime.

[www.akad.gov.al](http://www.akad.gov.al)

Shih në vijim linkun:

<https://ata.gov.al/.../instituti-i-gjuhesise-dhe.../>

<https://sot.com.al/.../ceshtje-te-morfologjise-se-sotme.../>

## Procesi i negociatave me Bashkimin Europian. Kapitulli 25 "Shkenca dhe kërkimi shkencor"

Komisioni për çështjet ekonomike juridike e sociale pranë Akademisë së Shkencave, më 28 tetor 2024, organizoi tryezën me temë: Progresi i negociatave me Bashkimin Europian. Kapitulli 25 "Shkenca dhe kërkimi shkencor".

Aktiviteti u zhvillua me prani fizike dhe online të pjesëmarrësve në sallën "Aleks Buda".



Pas informacionit në lidhje me Kapitullin 25 "Shkenca dhe kërkimi shkencor" dhe ecurinë në procesin e negociatave, diskutimi u përqendrua në projektligjin "Për shkencën dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë", i cili është duke u diskutuar në Kuvend.

Akad. Anastas Angjeli, kryetar i Komisionit dhe njëherazi drejtues i panelit u uroi mirëseardhjen dhe theksoi rëndësinë e kësaj tryeze, në fazën kur Bashkimi Europian (BE) ka hapur negociatat me Shqipërinë.

Akad. Skënder Gjinushi, Kryetar i Akademisë së Shkencave, përshëndeti të pranishmit dhe e njohu tryezën me kontributet e Akademisë së Shkencave për hartimin dhe konsultimin e projektligjit "Për shkencën dhe kërkimin shkencor në RSh", miratimi i të cilit është mjaft i rëndësishëm për përafrimin e legjislacionit shqiptar për kërkimin shkencor, me Acquis-në e BE-së.



Në lidhje me Kapitullin 25 “Shkenca dhe kërkimi shkencor” dhe procesin e negociatave, informoi z. Gerald Jaupaj, nga Drejtoria e Integritit, Ministria e Arsimit dhe e Sporteve.

Një analizë të projektligjit “Për shkencën dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë” dhe përafrimin e tij me standardet e Bashkimit Europian e parashtroi znj. Mirela Muça, drejtore e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit.

Akad. Aurela Anastasi kumtoi rolin dhe detyrat e Akademisë së Shkencave sipas këtij projektligji, duke theksuar parimin e bashkëpunimit institucional që ai sanksionon.

Folësit dhe të pranishmit diskutuan gjerësisht mbi rolin e institucioneve kërkimore-shkencore dhe rolin e studiuesit/shkencëtarit për zhvillimin e shoqërisë dhe, në veçanti, për çuarjen përpara të procesit të integritit të Shqipërisë në Bashkimin Europian.

## "Si ndërtohet një institucion i pavarur kulturor"

Leksion i hapur (lectio magistralis) në ASHSH nga z. Ares Shporta për çështje të trashëgimisë kulturore



Qendra e Studimit të Arteve organizoi sot ligjëratën e hapur (lectio magistralis) të z. Ares Shporta, drejtor ekzekutiv i fondacionit "Lumbardhi", i themeluar në vitin 2015.

Dr. Jonida Gashi moderoi veprimtarinë.

Z. Shporta foli për misionin e këtij fondacioni për të mbrojtur nga privatizimi dhe shkatërrimi kinemanë me të njëjtin emër, "Lumbardhi".

Ai tha se kinemaja "Lumbardhi" është një objekt i rëndësishëm i trashëgimisë kulturore, që tregon për historinë komplekse jo vetëm të Prizrenit, por edhe të Kosovës gjatë shekullit të njëzetë e deri në ditët e sotme.

Kinemaja "Lumbardhi" gjendet në një nga hapësirat kulturore më të rëndësishme të Prizrenit e më gjerë, ku janë zhvilluar ngjarje kulturore rajonale e ndërkombëtare dhe ku spikat veçanërisht marrëdhënia gati simbiotike me festivalin e



---

mirënjohur të filmit dokumentar "DokuFest".



Bashkëbisedimi me z.Shporta u përqendrua në mënyrat sesi këto modele e praktika alternative ndërlidhen me proceset e ruajtjes së trashëgimisë kulturore, të shtetndërtimit, të nxënies kolektive, si edhe të raportit të artit e kulturës me qytetin.

## "Courage for Future" - "Kurajë për të ardhmen"

- Samiti VIII për shkencën në vendet e Ballkanit Perëndimor në kuadër të Procesit të Berlinit filloi sot dhe vijon edhe më 1 tetor 2024 -



- Samiti organizohet nga Akademia e Shkencave e Gjermanisë "Leopoldina" dhe ALLEA, me pjesëmarrjen e drejtuesve e studiuesve të shquar nga rrjetet akademike-universitare të vendeve të Europës dhe të rajonit të BP -

- Akademia e Shkencave e Shqipërisë përfaqësohet nga anëtarët e Asamblesë së saj Neki Frashëri e Arben Merkoçi -

- Samiti VII, i vetmi jashtë BE, në një vend të Ballkanit Perëndimor, u organizua vjet në Tiranë, nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë, ALLEA dhe "Leopoldina" -

Konferenca u hap nga Gerald Haug, president i Akademisë "Leopoldina" dhe anëtar nderi i ASHSH, që foli mbi rolin e Procesit të Berlinit dhe të Akademisë "Leopoldina", duke renditur arritjet dhe vizionin për të ardhmen e intergrimit të Ballkanit

në BE.

Berlin Process  
Western Balkans  
8th Joint Science  
Conference: Mut  
zur Zukunft –  
Courage for Future



**Joint Science  
Conference**  
BERLIN PROCESS

Conference of the national stakeholders  
of the education and science systems in  
the framework of the Berlin Process for  
the Western Balkans

Date: Monday, 30 September to Tuesday, 1  
October 2024

Location: State Library Berlin, Unter den Linden 8,  
10117 Berlin

Konferenca u përshëndet nga znj. Stark-Watzinger, ministër për edukimin dhe shkencës, që njohu arritjet nëpërmjet rolit të shkencës dhe edukimit; si dhe sfidat e së ardhmes lidhur me drejtimet e reja teknologjike.

Në vijim përshëndeti z. Parzinger, president i Fondacionit për trashëgiminë kulturore të Gjermanisë.

U vijua me diskutime nga paneli për mbrojtjen e demokracisë dhe për idetë europiane në Ballkan; rreth "mbiprodhimit" të dukurive historike në rajon; rreth kuptimit të konceptit "ide europiane", rolit të edukimit dhe shkencës për bashkimin e njerëzve, veçanërisht rreth rolit të akademive; rreth raporteve "mazorancë versus minorancë" në qëndrimin ndaj emigracionit; rreth ndërlikueshmëritë lidhur me nacionalizmin; peshës të kërkimit në universitetet e Ballkanit Perëndimor; "ikjes së trurit"; problemeve të investimit në nivele shumë të ulëta (deri 10 herë më të vogla) në njerëzit dhe infrastrukturën; rreth rolit të institucioneve shkencore etj.

Në samit asistoi edhe Ambasadorja e Shqipërisë në Gjermani znj. Adia Sakiqi, e cila shprehu interesim për bashkëpunimin ndërakademik midis dy vendeve.

---

Libri i plotë i akteve të samitit në linkun në vijim:

<https://mail.google.com/mail/u/0/...>

Njoftime të tjera:

<https://www.leopoldina.org/en/events/event/event/3201/>

<https://westernbalkans-competitiveness.oecd.org/mRDnLDLRk...>

## U zhvillua simpoziumi shkencor “Çarls Darvini dhe mendimi modern”

-Veprimtaria u organizua nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë me rastin e 165-vjetorit të botimit të veprës “Origjina e specieve” -



Akademia e Shkencave e Shqipërisë, komisioni i biologjisë, bujqësisë dhe veterinarisë pranë saj, në bashkëpunim me Universitetin e Tiranës, Universitetin Bujqësor të Tiranës dhe Universitetin Europian të Tiranës zhvilluan më 24 tetor 2024 simpoziumin “Çarls Darvini dhe mendimi modern”.

Veprimtaria u organizua me rastin e 165-vjetorit të veprës madhore të Darvinit “Origjina e specieve” .

Akad. Ilia Mikerezi, Kryetar i Komisionit të Biologjisë, Bujqësisë dhe Veterinarisë çeli simpoziumin. Ai përshëndeti pjesëmarrësit e kësaj konference dhe tha se libri “Origjina e specieve” i Darvinit nga shumica e shkencëtarëve shihet si punimi shkencor që vuri themelet e biologjisë evolucionare. Ai theksoi se puna e Darvinit mbi evolucionin hapi rrugën për kërkime të tjera në shkencat moderne të Biologjisë si ekologjia, biologjia molekulare, gjenetika, psikologjia etj.

Akad. Gjinushi përgëzoi organizatorët dhe pjesëmarrësit për mbajtjen e këtij simpoziumi. Ai theksoi se vetë fakti që teoria e Darvinit është e debatueshme ka sjellë e do të sjellë zhvillime në kërkimin shkencor. Trajtimi i këtyre botimeve të rëndësishme që kanë tronditur mendimin shkencor në fushën e biologjisë është një domosdoshmëri

---

për të trajtuar temat e reja në këndvështrimin e sotëm.

Akad. Neki Frashëri kryetar i SSHNT përshëndeti organizatorët dhe vuri në dukje se çfarë problemesh dalin nga interpretimet joshkencore që po i bëhen teorisë së Darvinit dhe theksoi rolin qendror të informacionit që ka vepra e tij në zhvillimin dhe evolucionin e botës së gjallë.



Në këtë simpozium nga akad. Ilija Mikerezi, akad. Anila Hoda, prof. asoc. Ani Bajrami, prof. Valbona Aliko, prof. Aleksandër Dhima, prof. Ferdinand Bego, Fundime Miri, Mihalllaq Qirjo, Nelson Çabej, etj. prezantuan punimet shkencore përmes të cilave u diskutua dhe u debatua mbi idetë darviniane dhe rrugën e hapur prej tyre në këto fusha. U vunë në dukje arritje të reja në këto shkenca nën dritën e ideve evolucionare të Darvinit. U mbajtën referime për ndryshimet klimatike dhe biodiversitetin, pamundësinë dhe mundësinë e përshtatjes së llojeve në kushtet e ndryshimeve Klimatike, etj.

Diskutimet u shtrinë në këto drejtime kryesore:

- jehona e teorisë së evolucionit
- evolucionin dhe gjenetikën
- evolucionin dhe edukimin
- ndryshimet klimatike dhe biodiversitetin.

[www.akad.gov.al](http://www.akad.gov.al)

---

**Takime pune**

## Vizitë pune e kryetarit të Akademisë së Shkencave të Lituanisë akad. Jūras Banys në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë

Akad. Skënder Gjinushi dhe akad. Jūras Banys nënshkruajnë protokollin e bashkëpunimit mbështetur në marrëveshjen në fuqi

Prioritet bioteknologjia, nanoshkenca, kërkimet në gjenetikë dhe në shkencat e identitetit (gjuhësi, arkeologji, histori, trashëgimi)



Kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë akad. Skënder Gjinushi priti sot në një vizitë zyrtare pune kryetarin e Akademisë së Shkencave të Lituanisë akad. Jūras Banys.

Në delegacion bënin pjesë gjithashtu akad. Zenonas Dabkevičius, zëvendëskryetar i Akademisë së Shkencave të Lituanisë; akad. Leonas Valkūnas, kryetar i divizionit të shkencave matematikë-fizikë dhe kimi; Violeta Skirgailienė, drejtore për marrëdhëniet me jashtë.

Në këtë takim ishin të pranishëm përfaqësues të Kryesisë së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë: zëvendëskryetari akad. Vasil S.Tole; sekretari shkencor akad. Shaban Sinani, kryetari i Seksionit të Shkencave Natyrore dhe Teknike akad. Neki Frashëri; kryetari i Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike akad. Gëzim Hoxha; akad. Nazim Gruda, prof. asoc. dr. Elda Zotaj, përgjegjëse për marrëdhëniet me jashtë.

Ky takim vjen si rezultat i thellimit të bashkëpunimit midis dy akademive, të



cilat kanë institucionalizuar marrëdhënien ndërkademiçe dypalëshe përmes nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit një vit më parë në Vilnius, më 26 shtator 2023.



Akad. Skënder Gjinushi përmendi disa nga përvojat më të mira të Akademisë së Shkencave të Lituaniës, të vërejtura gjatë vizitës së delegacionit shqiptar në Lituani, si dhe njohu të pranishmit me zhvillimet aktuale në Akademinë Shkencave të Shqipërisë për arritjen e standardeve të kërkimit shkencor dhe institucioneve kërkimore në vend. Ndër të tjera ai theksoi si përvojë të suksesshme - rezultat i reformës - ngritjen e komisioneve të përhershme dhe të qendrave kërkimore, për të vijuar me synimin dhe ambicien e arritjes së standardeve europiane në funksionimin e tyre.



---

Akad. Jūras Banys shprehu falēnderimet pēr mikpritjen dhe tha se ndihej shumē i nderuar qē do tē njihej me eksperiencat e Akademisē sē Shkencave tē Shqipērisē. Jam shumē i kēnaqur dhe i surprizuar nē kētē vizitē tē parē nē Shqipēri, tha ai.

Kryetarēt e dy akademive diskutuan mbi hapēsirat dhe mundēsitē e bashkēpunimit tē komuniteteve tē kērkuesve shkencorē, pēr pjesēmarrjen nē projektet e pērbashkēta kērkimore, si konferencat dhe kongreset shkencore.

Mē pas ata nēnshkruan protokollin e marrēveshjes pēr bashkēpunim shkencor midis Akademisē sē Shkencave tē Shqipērisē dhe Akademisē sē Shkencave tē Lituaniēs.

Pērmes nēnshkrimit tē protokollit trevjeçar pēr bashkēpunim shkencor palēt bien dakord tē nxisin bashkēpunimin e shkencētarēve e studiuesve nē tē gjitha disiplinat me interes nē akademitē partnere.



Objektivi ēshtē tē krijohen mundēsi pēr studiuesit e tē dyja palëve pēr tē propozuar e realizuar projekte aktuale kērkimore nē vendin tjetēr, pēr tē ngritur komitete kērkimore tē pērbashkēta, qē ndērmarrin kērkime dypalēshe dhe organizojnē evente shkencore.

Pas firmosjes sē protokollit nē sallēn "Akademikēt" u bē një takim i zgjeruar i delegacionit me drejtues tē instituteve dhe qendrave shkencore tē Akademisē sē Shkencave tē Shqipērisē dhe tē komisioneve tē pērherhshme.

Pērfaqēsuesit e dy akademive diskutuan mbi mēnyrēn e organizimit dhe funksionimit tē instituteve dhe qendrave tē rrjeteve kērkimore pranē tyre; pēr organizimin e nismave shkencore nē tē ardhmen mbi bazēn e protokollit, qē do tē vijojē me ndarjen e eksperiencave pēr rritjen e kapaciteteve dhe cilēsisē sē kērkimit me

përfitim të ndërsjellët për të dyja palët.

Bashkëpunimet do të kenë prioritet bujqësinë, teknologjinë shkencore dhe informacionin gjenetik për bimësinë. Veçanërisht do të bashkëpunohet midis instituteve e qendrave kërkimore të bioteknologjisë dhe gjenetikës, të nanoteknologjisë; si dhe për botimet enciklopedike dhe ato në fushë të gjuhësisë, trashëgimisë, historisë dhe arkeologjisë.



Më pas delegacioni i Akademisë së Shkencave të Lituanisë bëri vizita në institutet e albanologjisë dhe në muzeun arkeologjik.

Gjatë qëndrimit treditör në Shqipëri delegacioni do të ketë takime pune me rektorin e Universitetit Bujqësor akad. F. Sallaku; me rektorin e Universitetit "Fan S. Noli" të Korçës prof. L. Ikonimi; me drejtues të qendrës rajonale të teknologjisë bujqësore në këtë qytet; vijuar me vizita në muze.

[www.akad.gov.al](http://www.akad.gov.al)

Shih dhe:

<https://akad.gov.al/vizite-pune-e-kryetarit-te-akademise.../>

<https://www.facebook.com/share/p/PrRnc9pev7HTmx7x/>

<https://www.facebook.com/share/p/MhsZpPvkA4ac4KKQ/>

---

## Kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë akad. Skënder Gjinushi pret në një takim zyrtar ambasadorin e Rumanisë z. Octavian Şerban



Ditën e sotme akad. Skënder Gjinushi, Kryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, priti në një vizitë zyrtare ambasadorin e Rumanisë z. Octavian Şerban.

Ambasadori shoqërohej dhe nga akad. Nicolae Saramandu, kryetar i Shoqatës Arumune "SCMR" në Rumani, si dhe studiueset Manuela Nevaci dhe Irina Florea, anëtarë të Institutit Linguistik "Iorgu Iordan" të Akademisë së Shkencave të Rumanisë. Në takim ishin dhe zëvendëskryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë akad. Vasil Tole, drejtori i Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë akad. Valter Memishaj dhe akad. Anila Hoda.

Ambasadori i Rumanisë z. Octavian Şerban vlerësoi marrëdhëniet e shkëlqyera mes dy vendeve dhe kontributin që kanë dhënë studiues dhe albanologë të shquar në thellimin e këtyre marrëdhënieve.

Akad. Gjinushi në fjalën e tij e vuri theksin tek bashkëpunimet e deritanishme, të cilat janë përforcuar me lidhjen e marrëveshjes mes Akademisë së Shkencave të Shqipërisë me Akademinë e Shkencave të Rumanisë dhe me Akademinë Rumune të Shkencave Bujqësore dhe Pyjeve "Gheorghe Ionescu-Sisestii".

Akad. Gjinushi bëri një prezantim të disa qendrave kërkimore-shkencore dhe

---

komisioneve drejtuese të punës shkencore pranë ASHSH. Ai theksoi se tashmë me institutet që i janë bashkuar kësaj akademie pritet të realizohen bashkëpunime edhe më të mira në të ardhmen.



Akad. Nicolae Saramandu kujtoi se për herë të parë ka ardhur në Shqipëri në vitin 1973, kohë kur Akademia e Shkencave nuk kishte as një vit që ishte themeluar. Ai u ndal në punën e akademikëve Eqrem Çabej, Shaban Demiraj, Gjovalin Shkurtaj etj., si dhe në kontributin me rastin e veprimtarive kushtuar 250-vjetorit të qytetërimit të Voskopojës dhe shekullit të iluminizmit në Ballkan, por edhe për pjesëmarrjen e studiuesve rumunë në Kuvendin e Studimeve Albanologjike (24-28 nëntor 2021 në Tiranë). Me këtë rast akademiku N. Saramandu u prezantoi kolegëve shqiptarë edicionin e parë në dialektin arumun të manualit në arumanisht “Manual për të mësuar arumanishten”, në gjuhën letrare rumune. Anëtarët e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë e vlerësuan këtë iniciativë, e cila do të forcojë lidhjet shkencore midis dy vendeve dhe njëkohësisht do të ndihmojë komunitetin arumun të Shqipërisë në ruajtjen e dialektit arumun dhe të kulturës së vet në dobi të të dy vendeve, Shqipërisë dhe Rumanisë.

Akad. Vasil Tole përmendi se studiues rumunë, albanologë e antropologë, kanë dhënë kontribute me vlerë në vendin tonë, dhe theksoi se shqiptarët dhe rumunët kanë pasur gjithmonë një marrëdhënie të ndërsjellët. Ai përmendi kontributin në shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë dhe u ndal veçanërisht tek ruajtja e dialektit arumun në

---

interpretimin e muzikës polifonike shqiptare. Gjithashtu akad. Tole u ndal tek muzika e Himnit Kombëtar, e krijuar nga kompozitori rumun Ciprian Porumbescu.



Akademia e Shkencave e Shqipërisë ka në rrethin e saj edhe anëtarë nderi rumunë, - tha akad. Tole, dhe vuri në dukje edhe bashkëpunimet mes instituteve të antropologjisë.

Të pranishmit vunë në dukje lidhjet e drejtpërdrejta me rumunët në arealin ballkanistik, ku theksuan se kultura, letërsia, gjuhësia kanë qenë burim i mirëfilltë shkencor dhe vlerësuan se ekspeditat linguistike dhe shkëmbimet e literaturave shkencore kanë qenë një komunikim i pandërprerë mes dy vendeve. Këtë komunikim e përforcojnë edhe lidhjet mijërvjeçare në historinë e dy popujve, dhe sidomos bashkëjetesa me popullsinë arumune të shpërndarë kryesisht në trevat jugore shqiptare.

[www.akad.gov.al](http://www.akad.gov.al)

---

## Kryetari i Akademisë së Shkencave priti sot në një takim përfaqësues të Universitetit "Mohamed bin Zayed për Shkenca Humane" të Abu Dabit



Kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë akad. Skënder Gjinushi priti në një takim përfaqësues të Universitetit "Mohamed bin Zayed për Shkenca Humane" të Abu Dabit.

Delegacioni përbëhej nga dr. Karima al Mazrouei, këshilltare; dr. Rashid al Menhali, koordinator për marrëdhëniet me publikun; z. Ali al Kaabi, specialist; si dhe kryetari i bordit drejtues të Institutit të Edukimit, Trashëgimisë dhe Turizmit (IETT) prof. dr. Ramiz Zekaj. Të pranishëm ishin gjithashtu zëvendëskryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë akad. Vasil S. Tole dhe kryetari i Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike akad. Gëzim Hoxha.

Takimi kishte si qëllim njohjen e ndërsjellë të institucioneve dhe gjetjen e fushave të bashkëpunimit për të ardhmen.

Kryetari i Akademisë së Shkencave akad. Skënder Gjinushi i njohu të pranishmit me vizionin, strukturën dhe funksionimin e Akademisë së Shkencave dhe zhvillimet më të fundit në fushën e kërkimit shkencor dhe projekteve.

Akad. Gjinushi foli për reformimin e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, e cila që prej janarit të këtij viti është zgjeruar me 4 institute albanologjike dhe dy qendra: Qendra e Biogjenetikës dhe Qendra e Studimit të Arteve, si dhe me njësi të përkohshme sipas disiplinave kryesore: të nanoteknologjisë, bioteknologjisë, mjekësisë e bujqësisë,

---

dhe me njësinë studimore “Për pasuritë ujore”.



Anëtarët e delegacionit prezantuan fushat e studimit, organizmin dhe misionin e Universitetit "Mohamed Bin Zayed për Shkenca Humane" në Abu Dabi. Pas prezantimeve, ata shprehën dëshirën për të mundësuar bashkëpunime në fusha me interes të përbashkët dhe bënë propozime për lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit, sidomos në fushën e kërkimit, në zhvillimin e teknologjisë dhe të inteligjencës artificiale etj.

Në fund të këtij takimi, anëtarët e delegacionit e falënderuan akad. Gjinushin dhe kryesinë e ASHSh për mikpritjen dhe shprehën konsiderata të larta për profilin që ka ASHSH, si dhe bindjen se arritjet e këtij institucioni janë esenciale për bashkëpunimin mes popujve dhe kulturave.

[www.akad.gov.al](http://www.akad.gov.al)



---

# **Mbledhje të komisioneve të përhershme të ASHSH**

## Komisioni i përhershëm i ekonomisë, shkencave sociale dhe juridike zhvilloi mbledhjen e radhës për sfidat e turizmit shqiptar



Ditën e martë, më 22 tetor 2024, Komisioni i përhershëm i ekonomisë, shkencave sociale dhe juridike zhvilloi mbledhjen e radhës në sallën "Akademikët".

Ishin të pranishëm të pranishëm akad. Anastas Angjeli, prof. dr. Andri Koxhaj, prof. asoc. dr. Nikollaq Pano, prof. dr. Klodiana Gorica, prof. dr. Ksenofon Krisafi, dr. Besmir Premalaj, ndërsa online morën pjesë akad. Aurela Anastasi, akad. Kosta Bajraba, akad. Adrian Civici, prof. dr. Selami Xhepa, dr. Ilirjana Nano.

Prof. dr. Klodiana Gorica referoi punimin shkencor "Integrimi i edukimit në turizëm: rrugëtimi drejt zhvillimit të zgjuar dhe komuniteteve të qëndrueshme". Ajo trajtoi sfidat e turizmit shqiptar në kontekstin rajonal, edukimin e turizmit në rajon, politikat e zhvillimit të turizmit si një fuqi ekonomike me potencial për të kontribuar drejtpërdrejt dhe tërthorazi në të gjitha objektivat globale etj.

Turizmi kulturor në Shqipëri shihet në disa këndvështrime, siç është turizmi i trashëgimisë si një formë e qëndrueshme, si dhe standardet e BE - duke përfshirë edukimin dhe trajnimin.

Sipas statistikave të prof. dr. Goricës, 40 për qind e turistëve vijnë për turizëm kulturor, por turizmi mund të jetë dhe një "minë me sahat" nga mënyra sesi duhet orientuar ky fluks. Duhet një investim që turizmi të sjellë sa më shumë të ardhura, që turisti të lërë sa më shumë para. Turizmi iu përket të gjithë aktorëve, tha prof. dr. Gorrica.

Në fund të ligjëratis pati diskutime nga të pranishmit.

---

Akad. Anastas Angjeli diskutoi për efektet e rënies ekonomike në turizëm dhe për ristrukturimin që po pëson ekonomia shqiptare, dhe domosdoshmërinë e një vizioni të gjerë.



U diskutua më tej mungesa e profesionistëve të aftë në industrinë e turizmit; përqendrimi në zhvillimin e aftësive dhe trajnimin praktik, si dhe identifikimi i tendencave në kërkesën për grupe të veçanta aftësish apo adresimi i konsideratave etike në kërkimin turistik.

U diskutua gjithashtu sigurimi i kurrikulave të përshtatura me nevojat e tregut, mungesa e një strategjie të duhur për sektorin e turizmit lidhur me arsimin, për modelin shqiptar të turizmit, integrimin në kurrikulat universitare, për treguesit cilësorë të turizmit, studimet për llojin e turizmit në Shqipëri etj.

[www.akad.gov.al](http://www.akad.gov.al)

---

# Vlerësime

---

## Autorja koreano-jugore Han Kang ka fituar çmimin Nobel në letërsi për vitin 2024



Autorja koreano-jugore Han Kang ka fituar çmimin Nobel në letërsi për vitin 2024 për thellësinë poetike në prozën e saj, ku shpalosen traumat historike dhe ekspozohet brishtësia e jetës njerëzore.

Han Kang (koreanisht: 한강) ka lindur më 27 nëntor 1970.

Ajo ka fituar çmimin Man Booker International Prize në vitin 2016 për romanin “Vegetarian”, që është gjithashtu një nga librat e saj të parë i përkthyer në anglisht.

Han Kang e filloi karrierën e saj me një poezi të botuar në revistën letrare “Literature and Society”. Që atëherë ajo ka fituar disa çmime.

Çmimi i letërsisë ka qenë prej kohësh i dominuar nga meshkujt, me vetëm 17 gra

---

në mesin e laureatëve të tij. Gruaja e fundit që fitoi ishte francezja Annie Ernaux, Nobel 2022 në letërsi.

<https://x.com/NobelPrize/status/1844332268191613152...>

---

## **Ermonela Jaho nderohet me çmimin “Artistja më e mirë e huaj” në Spanjë**

Ermonela Jaho, sopranoja shqiptare me famë botërore, anëtare e jashtme e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, më 22 tetor 2024, u nderua në Madrid me çmimin “Artistja më e mirë e huaj” për kontributin e saj të jashtëzakonshëm në lirikë dhe kulturë në Spanjë.

Ky çmim i është dorëzuar nga ministri spanjoll i drejtësisë.

Sopranoja shqiptare, në postimin e këtij lajmi në faqen personale të fb, shpreh kënaqësinë që i jep ky vlerësim, bashkë me falënderimet e përzemërta për publikun dhe vlerësimin që Spanja i bën artit të saj.

---

**Akademiku shqiptar Nazim Gruda zgjidhet zëvendëskryetar i Unionit të Akademive Europiane për Shkencën e Aplikuar në Bujqësi, Ushqim dhe Natyrë**



- Kryesia e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë e përgëzon akad. Grudën për suksesin e arritur

Akad. Nazim Gruda është zgjedhur zëvendëskryetar i Unionit të Akademive Europiane për Shkencën e Aplikuar në Bujqësi, Ushqim dhe Natyrë.

Zgjedhja e tij në këtë detyrë u bë në takimin XII të Asamblesë së Përgjithshme të Unionit të Akademive Europiane për Shkencën e Aplikuar në Bujqësi, Ushqim dhe Natyrë (UEAA), ku u mbajt dhe simpoziumi shkencor shoqëruar në datat 10-11 tetor 2024 në Bukuresht, Rumani.





Në certifikatën e firmosur nga kryetari i UEAA, prof.dr. Joan JeleV, cilësohet se akad. Gruda do të qëndrojë në këtë pozicion drejtues për dy vjet.

Akad. Nazim Gruda është anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Ai është një nga specialistët dhe shkencëtarët më të shquar në fushën e hortikulturës në Shqipëri dhe në Europë.

Për më shumë shih linkun:

<https://akad.gov.al/wp-content/uploads/2024/02/N.Gruda-1.pdf>

Shih linkun: <https://www.linkedin.com/.../upctnoticias.../...>

Shih linkun:

<https://www.upct.es/.../2024-10-11-el-profesor-visitante...>

---

## Nderohen me çmimin “Nobel” në shkencat ekonomike studiuesit Daron Acemoglu, Simon Johnson dhe James A. Robinson

Akademia Suedeze e Shkencave nderoi me çmimin Nobel në shkencat ekonomike tre studiuesit Daron Acemoglu, Simon Johnson dhe James A. Robinson.



Jakob Svensson, kryetar i komitetit për çmimin në shkencat ekonomike theksoi se

---

në studimin e tyre Daron Acemoglu, Simon Johnson dhe James A. Robinson argumentojnë se shoqëritë ku sundimi i ligjit dhe institucionet janë të dobëta, nuk gjenerojnë rritje apo ndryshim për përmirësimin e jetesës së popullsisë.

Reduktimi i diferencave të mëdha në të ardhura midis vendeve është një nga sfidat më të mëdha të kohës sonë. Laureatët kanë argumentuar rëndësinë e institucioneve për arritjen e kësaj.

Për sa kohë që sistemi politik garanton se ato do të mbeten në kontroll, askush nuk do t'u besojë premtimeve të tyre për reformat e ardhshme ekonomike. Sipas laureatëve, kjo është arsyeja pse nuk ka përmirësime.


Kjo paaftësi për të bërë premtime të besueshme për ndryshime pozitive mund të shpjegojë edhe pse demokratizimi ndodh rrallë.

Të tre nobelistët janë emigrantë që kanë studiuar në SHBA. Daron Acemoglu është turko-amerikan dhe Simon Johnson e James A. Robinson janë britaniko-amerikanë.

**<https://www.youtube.com/watch?v=r4IbCdIQbo4>**

**[www.akad.gov.al](http://www.akad.gov.al)**

## Shpallet çmimi Nobel 2024 në kimi për tre shkencëtarë



The graphic is a blue rectangular banner for the Nobel Prize in Chemistry 2024. At the top left is the Nobel Prize logo. To its right, the text reads "NOBELPRISET I KEMI 2024" and "THE NOBEL PRIZE IN CHEMISTRY 2024". At the top right is the logo of the Royal Swedish Academy of Sciences, "KUNGL. VETENSKAPS- AKADEMIEN" and "THE ROYAL SWEDISH ACADEMY OF SCIENCES". Below this, three portraits of the winners are shown. Each portrait has a vertical credit line on its left: "Photo: University of Washington" for David Baker, "Photo: The Royal Society" for Demis Hassabis, and "Photo: BAWA Foundation" for John M. Jumper. Under each portrait is the name and affiliation: David Baker (University of Washington, USA), Demis Hassabis (Google DeepMind, United Kingdom), and John M. Jumper (Google DeepMind, United Kingdom). Below the portraits are the award descriptions in Swedish and English: "för datorbaserad proteindesign" / "for computational protein design" and "för proteinstrukturprediktion" / "for protein structure prediction". At the bottom left is the hashtag "#NobelPrize" and at the bottom right is "THE NOBEL PRIZE".

**David Baker**  
University of Washington  
USA

*"för datorbaserad proteindesign"*  
*"for computational protein design"*

**Demis Hassabis**  
Google DeepMind  
United Kingdom

*"för proteinstrukturprediktion"*  
*"for protein structure prediction"*

**John M. Jumper**  
Google DeepMind  
United Kingdom

#NobelPrize

THE NOBEL PRIZE

Çmimi Nobel 2024 në kimi u nda në datën 9 tetor 2024 mes tre shkencëtarëve që kanë parashikuar dhe madje dizajnuar strukturën e proteinave, si bloqet ndërtuese të jetës që formojnë kockat, lëkurën, flokët dhe indet.

Gjysma e çmimit iu dha David Baker-it për kontributin e tij novator në hartimin e proteinave llogaritëse, një metodë që lejon shkencëtarët të krijojnë proteina me funksione të përshtatura. Gjysma tjetër iu dha shkencëtarëve Demis Hassabis dhe John M. Jumper për parashikimin e strukturës së proteinave.

David Baker punon në Universitetin e Uashingtonit në Seattle, ndërsa Demis Hassabis dhe John Jumper punojnë në Google DeepMind, një laborator kërkimor i inteligjencës artificiale britaniko-amerikane me bazë në Londër.

Hassabis dhe Jumper krijuan një model të inteligjencës artificiale që ka qenë në gjendje të parashikojë strukturën e pothuajse të gjitha 200 milionë proteinave që studiuesit kanë identifikuar.

Fituesi i çmimit Nobel për letërsi do të shpallet të enjten më 10 tetor 2024 në Stokholm.

Më 11 tetor 2024, në Oslo do të shpallet emri i fituesit të çmimit Nobel për paqe të këtij viti.

Emri i fituesit të çmimit Nobel në ekonomi do të bëhet i ditur më 14 tetor dhe do të shpallet në Stokholm.

---

<https://www.nobelprize.org/prizes/chemistry/2024/summary/>

## Ndahet Çmimi “Nobel” për fiziologji ose mjekësi

- Dy biologë amerikanë, Victor Ambros dhe Gary Ruvkun, u vlerësuan për zbulimin e mikroARN-së, që përcakton sesi rregullohet aktiviteti i gjeneve-



Sot në datën 7 shtator 2024 Komiteti i Çmimit Nobel në Suedi njofton se çmimi Nobel në fiziologji ose mjekësi u dha për Victor Ambros dhe Gary Ruvkun, për punën e tyre në zbulimin e mikroARN-së.

Komiteti i Nobelit vlerësoi “zbulimin novator” të biologëve amerikanë, që e publikuan në vitin 1993; MikroARN-në, një klasë e re e molekulave të vogla të ARN-së që luan një rol vendimtar në rregullimin e gjeneve.

Fituesit do të ndajnë një çmim rreth 810.000 £.


Vitin e kaluar, çmimi shkoi për hungarezo-amerikanen Katalin Kariko dhe amerikanin Drew Weissman për zbulimet e tyre novator që mundësuan zhvillimin e vaksinave mRNA kundër COVID-19, të cilat luajtën një rol vendimtar në luftimin e pandemisë.

Çmimi i këtij viti është çmimi i 115-të Nobel që jepet në fiziologji ose mjekësi që nga viti 1901. Nga 229 fitues, vetëm 13 kanë qenë gra.

Të martën do të shpallet Çmimi Nobel në fizikë, ndërsa Çmimi Nobel në kimi që do të shpallet ditën e mërkurë.

<https://www.nobelprize.org/prizes/medicine/2024/summary/>

## Geoffrey Hinton dhe John Hopfield fitojnë çmimin Nobel 2024 në fizikë për zbulime themelore që mundësojnë mësimin e makinerive me rrjete nervore artificiale



The graphic features a dark blue background. At the top left is the Nobel Prize medal. To its right, the text reads "NOBELPRISET I FYSIK 2024" and "THE NOBEL PRIZE IN PHYSICS 2024". On the top right is the logo of the Royal Swedish Academy of Sciences, with the text "KUNGL. VETENSKAPS-AKADEMIEN" and "THE ROYAL SWEDISH ACADEMY OF SCIENCES". Below this, two portraits are shown side-by-side. The left portrait is of John J. Hopfield, with a vertical photo credit "Photo: Mary Higham" to its left. Below his portrait is his name "John J. Hopfield" and affiliation "Princeton University, NJ, USA". The right portrait is of Geoffrey E. Hinton, with a vertical photo credit "Photo: University of Toronto" to its left. Below his portrait is his name "Geoffrey E. Hinton" and affiliation "University of Toronto, Canada". At the bottom, the Swedish citation is: "för grundläggande upptäckter och uppfinningar som möjliggör maskininläring med artificiella neuronnätverk". Below that is the English translation: "for foundational discoveries and inventions that enable machine learning with artificial neural networks". At the bottom left is the hashtag "#NobelPrize" and at the bottom right is the text "THE NOBEL PRIZE".

Çmimin Nobel në Fizikë u shpall ditën e martë, në datën 8 tetor 2024. Shkencëtarët John Hopfield dhe Geoffrey Hinton fituan Çmimin Nobel për zbulimet dhe shpikjet që mundësojnë mësimin e makinerive me rrjete nervore artificiale.

Geoffrey Hinton, profesor në Universitetin e Torontos në Kanada, konsiderohet si babai i inteligjencës artificiale. Ai është larguar nga Google për shkak të rezultateve të zbulimeve të fundit rreth IT, që e bënë të kuptojë se Google përbën një kërcënim për njerëzimin.

Fituesi tjetër i Nobel 2024 në Fizikë, John Hopfield, është profesor në Universitetin Princeton në Shtetet e Bashkuara.

“Edhe pse kompjuterët nuk mund të mendojnë, makineritë tani mund të imitojnë funksione të tilla si kujtesa dhe të mësuarit. Laureatët e këtij viti në fizikë kanë ndihmuar për ta bërë këtë të mundur”, -thuhet në deklaratën e Komitetit Nobel.

Hopfield krijoi një model kompjuterik të një rrjeti nervor nyjesh të ndërlidhura që mund të ndikojnë njëra-tjetrën, të ngjashme me ndërveprimet fizike midis atomeve në materialet magnetike.

Hinton u zgjerua në rrjetin e Hopfield duke përdorur metoda statistikore të

---

përdorura tradicionalisht për të përcaktuar vetitë e sistemeve me shumë elementë - si temperatura e një gazi të bërë nga shumë molekula.

Fituesit ndajnë një shpërblim prej gati 976,000 €.

Fizika është Nobeli i dytë që jepet këtë javë, pasi shkencëtarët amerikanë Victor Ambros dhe Gary Ruvkun fituan çmimin e mjekësisë për zbulimin e tyre të mikroARN dhe rolin e saj në rregullimin e gjeneve.

<https://www.nobelprize.org/prizes/physics/2024/hinton/facts/>

<https://www.nobelprize.org/.../physics/2024/hopfield/facts/>



---

# Promovime

## Akademiku Anastas Angjeli promovoi në Bankën e Shqipërisë librin “Institucionet e Bretton Woods dhe Shqipëria”



U zhvillua sot në datën 31 tetor 2024, në Bankën e Shqipërisë, ceremonia e promovimit të librit më të ri të akad. Anastas Angjelit, që titullohet “Institucionet e Bretton Woods dhe Shqipëria”.

Ky libër ofron një kolanë historike të ngjarjeve, shkaqeve dhe teorive ekonomike, të cilat i paraprinë krijimit të këtyre institucioneve.

Zëvendëskryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë akad. Vasil S. Tole mbajti një fjalë përshëndetëse në emër të këtij institucioni dhe shprehu vlerësimet për librin e akad. Anastas Angjelit.



Ai tha se jemi të një mendjeje me guvernatorin z. Gent Sejko, i cili në hyrje të botimit shprehet se: "... libri sjell së bashku historinë, ekonominë, financën dhe politikën, për të bërë një analizë të plotë dhe përshkrim të besueshëm të tendencave ekonomike e financiare".

Më tej, akad. Toke tha se punimet e akad. Angjelit janë në vazhden e traditës më të mirë të mendimit ekonomik shqiptar prej Rilindjes Kombëtare e deri më tani.

Ekonomia është kryefjala e botës studimore të autorit, dhe libri "Institucionet e Bretton Woods dhe Shqipëria" i shtohet natyrshëm kolanës studimore të tij, e cila kulmon me vepra si "Krizë ekonomike në kohën e koronavirusit" apo "Përballë krizës - sfidat e teorisë dhe politikave ekonomike", si dhe "Drejt një krize të re - energjia, inflacioni, rritje çmimesh, çoroditje e tregjeve".



Akademia e Shkencave e ka çmuar dhe e çmon veprimtarinë kërkimore shkencore në lëmin e ekonomisë të akad. Angjelit, pasi punimet e tij kanë objektivitet e akribi shkencore, analiza, fakte e bibliografi shteruese, e mbi të gjitha paanësi dhe përkushtim intelektual për zhvillimin dhe integrimin e vendit në Europë.

Akad. Toke vuri në dukje se për këto kontribute shkencore të besueshme, që i shërbejnë shkencës shqiptare dhe zhvillimit të vendit, çmimi më i lartë shkencor në fushën e shkencave albanologjike që jep Akademia e Shkencave "Eqrem Çabej" shkoi vitin e kaluar për veprën "Krizë ekonomike në kohën e koronavirusit", me autorë Anastas Angjeli dhe Adrian Civici.

Bota dhe zhvillimi i saj rregullohet duke u vetëkorrigjuar, kur shkenca thotë fjalën

---

e saj me kompetencë, ashtu siç e thanë fjalën e tyre së fundmi edhe studiuesit Acemoglu, Johnson dhe Robinson, fituesit e çmimit Nobel në ekonomi për vitin 2024, të cilët përmes punës së tyre kërkimore analizuan e vlerësuan sesi lloje të ndryshme të institucioneve koloniale të krijuara nga fuqitë europiane kanë ndikuar në trajektoret e zhvillimit afatgjatë të shteteve të kolonizuara.-tha akad. Tole.

[www.akad.gov.al](http://www.akad.gov.al)

Shih dhe lajmin në:

<https://youtu.be/uyvB0He5ikU?si=WJOgpJah70km4-5o>

---

**Të tjera**

## 155-vjetori i themelimit të Akademisë së Shkencave të Bullgarisë



Delegacioni i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, i kryesuar nga Kryetari i saj akad. Skënder Gjinushi dhe i përbërë nga akad. Vasil S. Tole (zëvendëskryetar) e prof. Hamit Kaba (drejtor i Institutit të Historisë), morën pjesë në ceremoninë festive kushtuar 155-vjetorit të themelimit të Akademisë së Shkencave të Bullgarisë.

Në këtë ceremoni kryetari i ASHSH akad. Skënder Gjinushi, në emër të Kryesisë dhe Asamblesë, i shprehu urimet më të përzemërta Kryetarit të Akademisë së Shkencave të Bullgarisë akad. Julian Revalsky-t.

Në fjalën e tij kryetari Gjinushi u ndal tek bashkëpunimi i shkëlqyer që ekziston mes dy akademive dhe se theksoi se kjo marrëdhënie do të vijojë me bashkëpunime të mëtejshme në të ardhmen. Ai theksoi se tradita e do që festimet jubilarë të bëhen bashkë me miqtë dhe se kjo është një ditë e rëndësishme edhe për ne: krahas urimeve të sinqerta gjejmë rastin të pohojmë dhe përkushtimin tonë për thellimin e bashkëpunimit mes institucioneve tona.

Aktivitetet festive do të vijojnë në Teatrin e Operas me ndarjen e çmimeve të Akademisë Bullgare për shkencën dhe mbajtjen e një koncerti dedikuar këtij event.



Në këtë ceremoni marrin pjesë edhe delegacione të akademive nga Rumania, Serbia, Kroacia, Estonia, Sllovenia, Armenia, Azerbaxhani, Mali i Zi.

[www.akad.gov.al](http://www.akad.gov.al)

---

**Kryesia e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë i dërgon letër ngushëllimi  
Kryesisë së Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës për ndarjen nga  
jeta të akademikut Tahir Emra**

Letër ngushëllimi

Kryesisë së Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës

I nderuar akad. Mehmet Kraja, të dashur kolegë,

Mësuam me dhimbje për ndarjen nga jeta të akademikut Tahir Emra, personalitet i njohur në Kosovë si piktor e profesor; drejtues institucionesh të rëndësishme arsimore e kulturore; figurë e nderuar si krijues e qytetar; individualitet i shënjuar i historisë së arteve pamore shqiptare, me njohje brenda e jashtë vendit; i pranishëm me veprën e tij në shumë ekspozita, galeri e studio artesh.

Kryesia e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë shpreh me këtë letër ngushëllimet e saj për këtë humbje jo vetëm për botën akademike-universitare në Kosovë, por edhe për artet tona; për të gjithë ata që u formuan prej tij; për miqtë dhe kolegët e shumtë; për familjen dhe të afërmit e tij.

Kryesia e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë

Tiranë, 7 tetor 2024

<https://www.facebook.com/share/p/Tjj25dGswT32uGx8/?mibextid=oFDknk>



**Ambasada e Zvicrës në Shqipëri, përmes një postimi në faqen zyrtare të saj, falënderon Akademinë e Shkencave të Shqipërisë për mikpritjen e simpoziumit kushtuar zvicëranit të famshëm Eugène Pittard, i cili bëri shumë për Shqipërinë**



“Një surprizë e këndshme ishte zbulimi i bustit të Pittard - trashëgimi e Akademisë”, shkruhet në faqen zyrtare.

Simpoziumi shkencor “Eugène Pittard, zvicëran i që bëri shumë për Shqipërinë” u mbajt më 9 tetor 2024 në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë.

Veprimtaria u përshëndet nga akad. Skënder Gjinushi, Kryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe znj. Ruth Huber, ambasadore e Konfederatës së Zvicrës në Tiranë.



Akad. Gjinushi e vlerësoi albanologun, arkeologun e etnologun Pittard edhe për kontributin që dha duke qëndruar në krah të shqiptarëve në ditët e periudhën më të vështirë të historisë së tyre, në atë të fillimit të shekullit XX, kur pavarësia e Shqipërisë e shpallur më 1912 nuk ishte njohur ende e kur ricopëtimi i saj pas Luftës së Parë Botërore ishte më se prezent.



Pittard e vlerësuan edhe prof. dr. Neritan Ceka (komisioni i arkeologjisë, ASHSH); arkeologu zviceran Albert Hafner (Universiteti i Bernës); akad. Shaban Sinani (sekretar shkencor, ASHSH) etj.

Shih dhe:

<https://ata.gov.al/.../eugene-pittard-zvicerani-qe.../...>

<https://www.tiranadiplomat.com/.../eugene-pittard.../>

**Studiuesi arbëresh Matteo Mandalà, anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave, përshëndet në emër të bashkësisë arbërore gjatë vizitës së Presidentit të Shqipërisë Begaj dhe të Presidentit të Italisë Mattarella në Sicili**

Pjesë nga përshëndetja (e plotë në linkun në fund të tekstit)



Kur paraardhësit tanë vendosën të lënë brigjet lindore të Adriatikut nuk e imagjinonin që në Itali do të ishin protagonistë të atij fenomeni që Pier Paolo Pasolini e përkufizoi saktësisht "mrekullia antropologjike arbëreshe".

Historia kulturore e arbëreshëve është konsideruar si një paradigmë e padeshifrueshme për një kohë të gjatë, pasi implikimet e saj sociale, historike dhe antropologjike ishin kaq komplekse dhe po aq pak të hulumtuara - e për këtë arsye të errëta.

Përkufizimi ikonik i Pier Paolo Pasolinit për "mrekullinë antropologjike arbëreshe", një prej ekspertëve më entuziastë të pakicave gjuhësore në Itali, shprehte habinë për mbijetesën shekullore të minoritetit arbëresh, i cili, megjithëse i shpërndarë në shtatë rajone të Italisë jugore, spikati në botën e larmishme të minoriteteve për dinamizmin e tij original.

Në kushtet e diasporës, arbëreshët jo vetëm që mbajtën gjallë gjuhën, kulturën, traditat dhe kujtesën e së shkuarës, por i kishin dhënë jetë, një rast unik ndër minoritetet gjuhësore italiane, një letërsie moderne të artit në gjuhën shqipe. Ata qenë të angazhuar si protagonistë në Risorgimento-n në Itali dhe në Rilindjen kombëtare në Shqipëri dhe nuk u kursyen si kontribues edhe për neohelenizmin grek.

Fjala e plotë në linkun në vijim:

[https://youtu.be/q\\_bKJyvCY44?si=24n75B-KkYC3A4DZ](https://youtu.be/q_bKJyvCY44?si=24n75B-KkYC3A4DZ)

[https://youtu.be/q\\_bKJyvCY44?si=24n75B-KkYC3A4DZ&t=111](https://youtu.be/q_bKJyvCY44?si=24n75B-KkYC3A4DZ&t=111)



Shih dhe:

<https://www.facebook.com/share/p/kUNN2tiMyHtqnEMV/>

<https://www.facebook.com/Prolocopianadeglialbnesi/videos/383738007320114>

---

**In memoriam**

---

## Pesë vite pa akademikun, kolegun dhe mikun tonë Salvatore Bushati



Më 25 tetor 2019 u nda nga jeta akad. Salvatore Bushati.

I lindur në Tiranë, më 1949, u diplomua si inxhinier gjeofizikan në Fakultetin e Gjeologjisë dhe Minierave të Universitetit Politeknik të Tiranës, në vitin 1974. Punoi në Shërbimin Gjeologjik Shqiptar me detyrën inxhinier gjeofizikan. Kreu një sërë kualifikimesh pasuniversitare në Shqipëri dhe jashtë saj, si në Universitetin “Pierre Marie Curie” dhe pothuaj në të gjitha vendet e Europës e më gjerë. Pati një karrierë të pasur shkencore, profesionale dhe pedagogjike. Në fillimet e para të veprimtarisë së tij ai drejtoi grupin kërkimor shkencor në studimet eksperimentale mbi mundësitë e përdorimit të metodave gjeofizike në kërkimin e mineralit të kromit në Shqipëri, duke vendosur bazat metodike gjeofizike, teorike dhe praktike të përdorimit të gravimetrisë e magnetometrisë në kërkimin e kromit (1973-1980), studime këto që u konkretizuan me projekte e

---

zbulime të shumta të kromit në Shqipëri.

Në vitin 1981 krijoi dhe drejtoi Departamentin e Kërkimeve Krahinore Gjeofizike dhe Gjeokimike dhe ndërmoi kryerjen e disa studimeve që kryheshin për herë të parë në Shqipëri. Gjatë viteve 1995–1999, drejtoi Qendrën e Kërkimeve Gjeofizike, Gjeokimike dhe të Mjedisit, të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, duke e fuqizuar atë në një institucion bashkëkohor të studimeve e kërkimeve aplikative e bazë.

Në vitin 1999 drejtoi Njësinë e Projekteve të Kërkimit, Zhvillimit Teknologjik e Inovacionit pranë ASHSH; në vitet 2002-2007 dhe 2013-2019 ka drejtuar Seksionin e shkencave natyrore dhe teknike; më 2008 u zgjodh anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe më pas zgjidhet nga Asambleja e Akademisë, sekretar shkencor i saj (2009–2013), duke dhënë një kontribut të çmuar në këtë institucion, detyrë që e rimori me zgjedhje në maj të vitit 2019.

Në vitin 2010 u zgjodh anëtar i Akademisë Europiane të Shkencave dhe Arteve, Austri.

Ai ishte nismëtar i ndërtimit të Observatorit Gjeomagnetik në Shqipëri dhe i programit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, “Edukimi në shkencë”.

Fushat shkencore të veprimtarisë së Salvatore Bushatit në shkencat e tokës dhe ato gjeofizike ishin: inxhinieri gjeofizike (prej 1974); aplikimi i metodave matematikore në përpunimin e të dhënave dhe interpretimin e informacionit me anë të kompjuterit, krijimi i programeve të algoritmit për këto qëllime (prej 1972); aplikimi dhe baza e studimeve mbi metodat e reja gjeofizike, si graviteti dhe magnetizmi (prej 1974) dhe ajo e mikrorilevimeve magnetike (prej 1975) në zbulimin e vendburimeve minerale, të kromit e bakrit; studimet rajonale gjeofizike të gravitetit (prej 1980); studime rajonale gjeofizike magnetike (prej 1981); zgjerimi i fushës së aplikimit të metodave gjeofizike në kërkimin e kromit, bakrit, asbestit, boksiteve, mineraleve të rënda, të rralla e të çmuara; në studimin në fushën e inxhinierisë gjeologjike dhe hidrogeologjisë; me aplikimin e gravitetit dhe metodat magnetike (prej 1980); rrjeti magnetik i Shqipërisë (prej 1987); kartografimet magnetike (të detajuara prej 1975 dhe ato rajonale prej 1978); rrjeti gravitacional i Shqipërisë (prej 1988); kartografimet gravimetrike (të detajuara prej 1974 dhe ato rajonale prej 1978); studime paleomagnetike (prej 1992); studime gjeotermike (prej 2001).

Në ceremoninë mortore (25 tetor 2019), kryetari i ASHSH akad. Skënder Gjinushi u shpreh mes të tjerash: “Ti ishe njeriu që meritoi aq shumë mirënjohje shoqërore e zyrtare. U vlerësove me Medaljen e Punës për veprimtari të shquar në përpilimin e hartave gjeofizike për Hartën e re Gjeologjike. Fitove Diskun e Artë, Për kontribut të veçantë në shkencën dhe shoqërinë ndërkombëtare, akredituar nga Bashkësia e Shkencave të Tokës në SHBA. Meritove Medaljen e Nderit për kontributin origjinal në Simpoziumin I Ndërkombëtar të Studimeve të Nismës së Kooperimit të Detit të Zi. U nderove me

---

Medaljen Për bashkëpunim të çmuar nga Instituti i Kërkimeve dhe

Didaktikës së Mjedisit. Fitove patentën e njohur europiane Sensori poli-parametrik. Ti ishe një shkencëtar shqiptar e europian, kontributet e tua njihen e nderohen edhe nga vendet fqinje, me të cilat bashkëpunove si projektues i zoti dhe realizues i suksesshëm.

Veprat e tua kryesore: 1. Studimi gravimetrik krahinor i Shqipërisë; 2. Harta gravimetrike e Shqipërisë (në gjuhën angleze); 3. Studimi i fushës geomagnetike i Shqipërisë; 4. Njësimi i hartës gravimetrike dhe magnetike të Shqipërisë, Greqisë dhe vendeve të tjera të Ballkanit (në gjuhën angleze); 5. Harta e parë magnetike e Shqipërisë (në gjuhën angleze); 6. Kuantifikimi tektonik i Shqipërisë në ditët e sotme (në gjuhën angleze); 7. Gjeofizika e zbatuar në shkencat e Tokës, do të jenë gjithnjë në duart e ekspertëve të rinj të fushave që ke krijuar dhe që do të jenë të pandara nga emri yt".



---

## Ndahet nga jeta akademik Tahir Emra, një ndër piktorët më të shquar të artit kosovar e shqiptar



Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës njoftoi me hidhërim për ndarjen nga jeta të akademikut Tahir Emra, një ndër piktorët më të shquar të artit kosovar e shqiptar.

Akademik Emra u lind në Gjakovë në vitin 1938. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa shkollën e mesme të artit në vitin 1959 në qytetin e Pejës. Në vitin 1966 përfundoi studimet universitare për pikturë në Akademinë e Arteve Figurative në Beograd. Në vitin 1970 vijoi studimet pasuniversitare dhe magjistroi në vitin në vitin 1974. Ai ka qenë docenti dhe prodekani i parë shqiptar në Akademinë e porsathemeluar të Arteve të Universitetit të Prishtinës si dhe shef katedre për dy mandate.

Akademik Emra ka qenë anëtar korrespondent i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, i zgjedhur në vitin 2000; ndërsa anëtar i rregullt i Akademisë është zgjedhur në vitin 2008. Për një mandat ka mbajtur pozicionin e sekretarit të Seksionit të

---

Arteve të ASHAK-ut.

Aktiviteti i tij në fushën e arteve figurative përfshin hapjen e disa ekspozitave vetjake dhe pjesëmarrjen në shumë ekspozita kolektive brenda dhe jashtë vendit. Veprat e tij gjenden në shumë galeri e muze të botës, në institucione dhe në koleksione private.

Në vitin 2013 Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës botoi monografinë e piktorit Tahir Emra, me riprodhimet e veprave më të njohura, ku përfshihet dhe studimi i piktorit Kujtim Buza.

Akademia e Shkencave e Shqipërisë i shpreh ngushëllimet e saj të sinqerta ASHAK-ut, familjes Emra, miqve dhe gjithë dashamirësve të veprës së tij.

<https://ashak.org/njofitim-mortor-nderron-jete.../...>

[www.akad.gov.al](http://www.akad.gov.al)